



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË

AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
TIRANË

Për projektin IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”

Tiranë Korrik 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Përmbajtja.

Emërtimi	Faqe
I Përmbledhje ekzekutive	3-7
II. Hyrje	7-9
III. Përshkrimi i auditimit	9-43
1. Kuadri ligjor i miratuar në lidhje me përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) në kuadrin e implementimit të fondeve IPA 2013 si dhe ndryshimet e tij gjatë implementimit. Përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit referuar kontratave të miratuara për përfituesin (listimeve të miratuara).	9-13
2. Komunikimet zyrtare në lidhje me përfitimet konkrete, opinionet e dhëna për draft raportet e paraqitura nga menaxhimi i projektit, apo dakordësitë mbi to.	13-15
3. Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrit rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2013 për përfituesin AKU.	15-37
4. Përdorimi me efektivitet i pajisjeve dhe trajnimeve të përfituara nga AKU pas periudhës së përfitimit, për kryerjen së funksioneve të saj konform kërkesave ligjore.	37-43
IV. Gjetjet dhe rekomandimet	43-48
V. Konkluzione dhe opinioni i auditimit	48-51
VI. Anekset	51-61



I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) auditoi Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) Tiranë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përfitimeve të AKU në drejtim të pajisjeve dhe trajnimeve në kuadër të implementimit të projektit IPA 2013, referuar objektivave dhe qëllimeve të projektit si dhe përmirësimin e funksioneve të AKU në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga ligjet në fuqi, referuar implementimit të këtij projekti dhe përfitimeve prej tij.

Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes dhe fakti i marrjes në dorëzim të pajisjeve të përfituara konform specifikimeve teknike e dokumentacionit shoqërues të tyre, regjistrimet dhe përdorimet konform legjislacionit në fuqi dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Rëndësia e këtij auditimi për KLSH është përcaktuar nga pikëpamja shoqërore pasi ka të bëjë me çështje shumë sensitive të shëndetit të popullsisë që janë të lidhura ngushtë me sigurinë ushqimore dhe të produkteve, shëndetin e kafshëve, gjë që kërkon një ristrukturim dhe forcim të rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri. Emërtimi i projektit të financimit të fondeve IPA 2013 paraqet pikërisht këtë gjë dhe që i shërben plotësimit të nevojave të përfituesve me pajisje dhe trajnime si dhe hartimi i një strategjie për forcimin e rrjetit të laboratorëve në drejtimet e përcaktuara nga projekti.

Në kuadër të implementimit të Projektit të financuar nga Programi IPA 2013: “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, rezulton se Agjencia Kombëtare e Ushqimit është pjesë e qenësishme dhe tepër aktive si përfituese e benefiteve të Projektit.

Ekspertët Ndërkombëtar që përfaqësojnë Projektin e financuar nga BE, së bashku me ekspertë të tjerë, kanë vendosur theksin në ngritjen e kapaciteteve për analizimin e shpejtë dhe kryerjen e testeve të menjëhershme mbi përbërësit e një produkti final dhe identifikimi i falsifikimeve të mundshme të tyre.

Problematika e mësipërme është mjaft e rëndësishme në fushëveprimin e AKU-së gjatë kryerjes së kontrolleve zyrtare dhe procedurave të mëtejshme laboratorike pasi ndikon në sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore dhe informacionin mbi to tek konsumatori i fundit, dhe që përbën misionin e vetë institucionit.

Projekti IPA 2013 mbi “Ristrukturimin dhe forcimin e rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” ka një afat kohor të implementimit Korrik 2016 – Korrik 2019

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është me 11 laboratorët e sigurisë ushqimore, 11 laboratorët e shëndetit të kafshëve dhe 7 laboratorë të shëndetit të bimëve. Analizat kryesore të kryera në sigurinë ushqimore bëhen me metodat fizike/kimike, metodat mikrobiologjike.

Sistemi i rrjetit laboratorik duhet të kryejë analizat e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit. Duke ndjekur informacionet e ofruara nga studimi bazë financiar nga një projekt i mëparshëm i IPA-s rezultoi nevoja për të kryer një reformë të rëndësishme në sistemin e laboratorit dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të saj për të siguruar informacion të besueshëm për rreziqet e lindura të ushqimit.

Një politikë e tillë mund të kërkojë që shumica e laboratorëve rajonalë të kryejnë matje të thjeshta bazë të bëra nga shqyrtimi dhe testet e shpejtë diagnostikuese, ndërsa konfirmimi do të kryhet në laboratorët referencë.

Për këtë nga ekspertët të projektit janë bërë vizita për të identifikuar gjendjen e rrjetit të laboratorëve dhe nevojave për pajisje të tyre. Referuar gjendjes së identifikuar nga ekspertët është përcaktuar një listë fillestare e pajisjeve të nevojshme e cila është dakordësuar nga AKU dhe dërguar me propozimet përkatëse në lidhje me mënyrën e organizimit të AKU. Referuar vendimmarrjes përfundimtare ka rezultuar se kjo listë fillestare është pakësuar në disfavor të AKU duke pakësuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

numrin e DRAKU–ve përfituese nga 5 në 3 për rrjedhojë dhe numrin e pajisjeve të përfituara. Vlen për tu përmendur se ky numër i pajisjeve të përfituara është pakësuar edhe si rezultat i mosrealizimit të tenderit për pajisjet e Lotit 2, që paraqesin pajisjet laboratorike për përcaktimin e parametrave mikrobiologjik në lëndët ushqimore, për testimin mikrobiologjik të molekulave. AKU nuk përfiton asnjë pajisje nga ky LOT. Në faqen zyrtare të Komunitetit Evropian është dhënë ky koment për arsyen e anulimit: “mungesë fondesh për shkak të skadimit të afatit të kontratës për Programin Kombëtar IPA 2013 gjatë procesit të vlerësimit të Lotit 2 “Testimi Mikrobiologjik”. Autoriteti Kontraktor nuk do të rifillojë tenderin për Lotin 2.”

Referuar raporteve mujore të paraqitura gjatë implementimit të projektit, strategjia dhe struktura janë propozuar në fazat e mëvonshme të Projektit (datë 19.12.2018, dokumenti “Letër Pune 29”), në një kohë që referuar aktiviteteteve të miratuara për implementimin e projektit, miratimi i tyre si dokumente strategjie duhej t’i paraprinte furnizimit me pajisje dhe realizimit të trajnimeve të stafit laboratorik. Edhe në momentin e këtij auditimi nuk ka vendimmarrje përfundimtare për strategjinë. Gjithashtu referuar dokumentit “Letër Pune 29” ku propozohet mënyra e organizimit të rrjetit laboratorik, në propozimin e paraqitur rrjeti laboratorik i AKU do të jetë i organizuar në dy nivele:

- labororë primarë qendrorë të kontrollit zyrtar,
- si dhe gjashtë labororë rajonalë të kontrollit, të pajisur me pajisje analizatorë të shpejtë multi-parametrikë, në mënyrë që të kryejnë “teste të shpejta” fiziko-kimike për cilësinë ushqimore; si dhe të gjitha standardet parametrike të testeve mikrobiologjike dhe bakteriologjike (shëndeti i kafshëve) dhe shëndetit bimor.

Referuar këtij propozimi për organizimin e nivelit të laboratorëve dhe përfitimeve deri në momentin e këtij auditimi, në kuadër të projektit IPA 2013 konkludojmë:

a-Për labororët primarë qendrorë të kontrollit zyrtar, nuk ka financim as në pajisje, as trajnime për t’u përshtatur në kontekstin e strategjisë së propozuar dhe objektivat e projektit.

b-Për gjashtë labororët rajonalë të propozuar, përfitimet nga projekti në pajisje kanë qenë vetëm në tre prej tyre (Korça,Shkodra,Gjirokastra), me pajisje të Loteve 1, 3 dhe 4; ku përzgjedhja e këtyre laboratorëve nuk ka një studim lidhur me:

- numrin e mostrave të analizuar nga secili laborator,
- kategori matricash (kategori e analizave),
- infrastruktura,
- stafi,
- afërsia me pikat e inspektimit kufitar dhe pikun e tyre.

Mbështetur në materialet sa më sipër cituam, krahasuar me objektivat dhe qëllimin e projektit rezulton se përfitimet e AKU pjesë e institucioneve përfituese në kuadrin e implementimit të Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigorisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” janë të një niveli shumë të pamjaftueshëm për të arritur sigurinë ushqimore apo për të kryer funksionet e këtij institucioni konform ligjit.

Gjatë realizimit të auditimit të drejtimeve të auditimit në lidhje me:

- Marrjen në dorëzim të përfitimeve konform kuadrit rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2013 për përfituesin AKU.

-Përdorimi me efektivitet i pajisjeve dhe trajnimeve të përfituara nga AKU pas periudhës së përfitimit, për kryerjen së funksioneve të saj konform kërkesave ligjore, kanë rezultuar gjetje të auditimit për të cilat, grupi i auditimit ka propozuar rekomandime në drejtim tëharrjes së masave dhe përmirësim të situatave të krijuara nga shkelja e kërkesave kontraktore dhe ligjore në fuqi, ku ndër më kryesoret po i paraqesim sa më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR A	RËNDËSI A	REKOMANDIMI	
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në DRAKU Korçë Shkodër e Gjirokastrë kanë rezultuar respektivisht 3, 4,4 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:</p> <p>1-Pajisja MPA_2 (Near Infra Red Food multiparametric analyzer) Aktualisht pajisja e paraqitur mat 1-3 parametra të disa produkteve dhe jo të gjitha, aq më tepër ato që konsiderohen analiza të domosdoshme për produktin që analizohet. Pra kjo pajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Pajisja është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme dhe një pjesë analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”</p> <p>2-Pajisja MPA_3 (Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser) kjo pajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Pajisja gjithashtu është e pa kalibruar (nga testimi nxjerr rezultate analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”</p> <p>3-Pajisja MPA_5 (Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyzer) Kjo pajisje është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar analiza të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”</p> <p><u>Nga auditimi në DRAKU Shkodër dhe Gjirokastrë</u> kanë rezultuar 4 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:</p> <p>-Tre pajisjet; Near Infra Red Food multiparametric analyzer; Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser; dhe Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyzer, janë të pakalibruara, dhe jo me të gjitha parametrat e kërkuara në specifikimet teknike, për rrjedhojë janë të pa përdorshme për të dhënë një rezultat të saktë laboratorik. Pajisjet duhet të kalibrohen nga furnitori sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt, në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë. Gjithashtu pajisja analizuuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët, shërben për matjen e; (1)proteinave, (2) yndyrave, (3) densitetin, (4) laktozën, (5) kripshmërinë, (6) SNF (të ngurta jo yndyrore), (7) ujë i shtuar.</p> <p>Kontraktori në ofertën e vet ka ofruar që pajisja kryen edhe matjen e (8) pH, dhe (9) përcjellshmërinë elektike. Pajisja aktualisht nuk i kryen të gjitha analizat e specifikuar. Në printimin e spektrit të analizave, që kjo pajisje nxjerr, nuk shfaqet si vlerë pH dhe përcjellshmëria elektrike. Në të nuk kishte të montuar pH-metrin, shtesë që duhet të vinte bashkë me pajisjen referuar manualit të ofruar nga ofertuesi fitues. Gjithashtu sa më sipër parashtuar për pajisjet citojmë se Kontrata “Furnizim për laboratorët ushqimorë në Drejtorinë</p>		Niveli i Riskut: i lartë	<p>1.1. Rekomandimi: - Nga DRAKU Korçë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2 MPA_3 MPA_5), deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.</p> <p>Menjëherë</p> <p>1.2. Rekomandimi: - Nga DRAKU Shkodër dhe Gjirokastrë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2 MPA_3 MPA_5), deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.</p> <p>-Nga DRAKU Shkodër dhe Gjirokastrë ti kërkohet furnitorit pajisja e pH-metrin shtesë për pajisjen analizuuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët konform ofertës së paraqitur, si kusht për marrjen përfundimtare në dorëzim të saj.</p> <p>Menjëherë</p> <p>1.3.Rekomandimi: Nga SPO në MBZHR referuar faktit të angazhimit të saj në procesin e marrjes provizore në dorëzim në bashkëpunim me furnitorin të hartohet një plan afatshkurtë i detajuar me afate kohore e përgjegjësi për kalibrimin apo axhustimin e tre pajisjeve për të gjithë</p>	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR A	RËNDËSI A	REKOMANDIMI	
	<p>rajonale ISFV dhe NFA” me 3 lote në total 1,937,593 Euro, nga të cilat IPA në vlerë 1,608,202 Euro dhe Buxheti i Shtetit në vlerë 329,390 Euro, me kontraktorë <i>Evita Ltd</i> për Lot 1 me vlerë 457,973 Euro pa TVSH, nga të cilat IPA 380,117 Euro dhe Buxheti i Shtetit 77,855 Euro, është lidhur nga CFCU dhe pagesat janë kryer prej saj duke dhënë miratimin për kryerjen e pagesës, dhe duke u mjaftuar me dorëzimin e pajisjeve dhe specifikimeve teknike të kontratës, në një moment ku nuk mund të arriheshin rezultate të pritshme nga kalibrimet e kryera, nuk mund të siguroheshe funksionaliteti i pajisjeve për dhënien e analizave të sakta.</p>			<p>laboratorët përfitues pa kosto shtesë nga përfituesit. Koha e përfundimit të jetë mundësisht brenda periudhës së garancisë së kontratës.</p> <p>Menjëherë 1.4.Rekomandimi: Nga CFCU të bëhet bllokimi i garancisë së kontratës prej 10% të parashkuar në pikën 12 të njoftimit të kontratës së furnizimit për kontraktin <i>Evita Ltd</i> për Lot 1 deri në momentin e përfundimit të procesit të axhustimit apo kolaudimit të pajisjeve (sipas planit të axhustimit të miratuar nga palët). Nga CFCU në marrëdhëniet me kontraktin të zbatohen të gjitha sanksionet e parashkuara në kontratë,(ku në rast mos përcaktimi në kontratë, sanksionet të vendosen në zbatim të akteve ligjore shqiptare apo të huaja mbi bazën e të cilave funksionon kontrata) për tejkalim të afateve të dorëzimit të pajisjeve të gatshme për përdorim.</p> <p>1.5.Rekomandimi: Nga CFCUnë rastin e dështimit të procesit të kolaudimit të pajisjeve nga furnitori të nis procedurat ligjore për arkëtimin e shumave të vlerës së pajisjeve të pa kolauduara dhe dëmin ekonomik të shkaktuar.</p>	
2.	<p>2. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi në DRAKU Korçë e Shkodër e Gjirokastër rezultoi se pajisjet e furnizuara dhe të përfituara referuar Lotit 1, Lotit 3, Lotit 4 nuk janë bërë hyrje, për rrjedhojë nuk ka gjurmë regjistrimi në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të vitit 2018, pavarësisht se akti i marrjes në dorëzim provizor mban datën 15.11.2018 për Lotin 3 dhe 4 dhe në dhjetor 2018 për Lotin 1. Argumenti i dhënë nga zyrat e financës së DRAKU Korçë e DRAKU Shkodër ka qenë mungesa e faturës që shoqëronte mallin. Aktualisht mos regjistrimi në kohën e marrjes në dorëzim bie në kundërshtim me SKK5 (pasi pajisjet quhen të gatshme për përdorim). Gjithashtu mos regjistrimi kontabël bie në kundërshtim dhe me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60. Nga struktura urdhëruese e marrjes në dorëzim SPO e MBZHR nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni i duhur ashtu siç përcaktohet në kushtet specifike të publikuara</p>		<p><i>Niveli i Riskut: i lartë</i></p>	<p>2.1. Rekomandimi: Nga SPO në komunikim me CFCU të përgatitet dokumentacioni konform artikullit 29” dorëzimi” i kontratave të projekteve IPA dhe ky dokumentacion ti vihet në dispozicion Institucioneve përfituese.</p> <p>Menjëherë 2.2 Rekomandim : Nga DRAKU Korçë ,DRAKU Shkodër e Gjirokastër në bazë të dokumentacionit që duhet të vihet në dispozicion, të kryhet regjistrimi i aseteve (pajisje) dhe kontabilizimi</p>	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR A	RËNDËSI A	REKOMANDIMI	
	<p>nga BE për kontratat e projekteve IPA në artikulli 29 “Dorëzimi” ku theksohet specifikisht: “Çdo ofertë duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:1. sigurim kontrate, 2. lista e paketimit, 3. faturë, 4. garanci certifikate (duke përfshirë procedurat e kërkesave), 5. certifikatën e origjinës (Certifikata e origjinës duhet të identifikojë qartë mallrat që i referohet). Nga MBZHR dokumentacioni i marrjes në dorëzimi vënë në dispozicion të përfituesve ka qenë vetëm specifikimet teknike të loteve të kontraktuara dhe ato të ofertuesit për to kjo e specifikuar dhe në urdhrat e titullarit për ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim.</p>			<p><i>në llogaritë përkatëse konform standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe akteve ligjore në fuqi.</i> Menjëherë</p>	
3.	<p>3. Gjetje nga auditimi :</p> <p>Nga auditimi i kryer në DRAKU Korçë, Shkodër, u konstatua se asnjë pajisje nuk është vënë në përdorim. Këtu flitet për ato pajisje të cilat janë në kushtet e përdorimit. Argumenti i paraqitur janë tarifave të munguara për të bërë të mundur përdorimin e tyre.</p> <p>Për këtë AKU i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR me shkresën nr.6999, datë 5.10.2018 “Kërkesë për miratimin e tarifave të munguara në udhëzimin nr. 8, datë 8.05.2007”(ky udhëzim është miratuar nga dy ministrat: të Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), <i>ku në paragrafin e parë të shkresës, citohet nevoja e miratimit të tarifave për pajisjet e përfituara.</i> Me shkresën nr.9377/1, datë 17.10.2018 në përgjigjen e dhënë nga MBZHR konfirmohet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i dy anëtarëve nga AKU. Me shkresën nr.6999/2, datë 5.11.2018, AKU, konfirmon dy anëtarët që të jenë pjesë e grupit. Nga AKU është rikujtuar MBZHR për kërkesën e saj me i-maill-in e datës 1.2.2019 drejtuar zotit E.H. duke i vënë bashkëlidhur dhe kërkesat e mëparshme. Deri në këtë moment nuk ka asnjë zhvillim në lidhje me përcaktimin e tarifave.</p> <p>Në VKM Nr.432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet Buxhetore”, parashikohet që tarifave për të ardhurat që realizojnë institucionet nga veprimtaria e tyre ekonomike miratohen nga Ministri i Financave me propozim të Ministrisë /institucionit qendror përkatës.</p> <p>Aktualisht nga AKU dhe degët e saj nuk ka ndonjë studim për kostot e analizave për të cilat kërkohen tarifa për tu miratuar.</p>		<p><i>Niveli i Riskut: i lartë</i></p>	<p>4.1 Rekomandim: <i>Nga ana e AKU të ngrihet grup pune për përcaktimin e kostove të realizimit të analizave që prodhohen nga përdorimi i pajisjeve të përfituara nga tre Lotet, ku në përbërjen e të cilit të jenë edhe punonjës nga të tre DRAKU- të përfitues.</i></p> <p><i>Tarifat e përcaktuara sipas kostove efektive të përdorimit të pajisjeve dhe konsumit të materialeve të nevojshme për prodhimin e analizave, ti dërgohen për vazhdimin e procedurës së miratimit të tyre në MBZHR, në referencë të procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.</i> Menjëherë</p>	
4.	<p>4.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, punonjësit e laboratorëve nuk janë trajnuar nga Projekti IPA 2019 për pajisjet e përfituara, në lotin 1. Kjo në kundërshtim me “Letrën e punës numër 9, datë 14.04.2017”.</p>		<p><i>Niveli i riskut: i mesëm</i></p>	<p>4. Rekomandim:<i>AKU të informojë CFCU për të planifikuar trajnime që kanë të bëjnë me pajisjet e përfituara, përfshirë metodologjinë kalibruese, verifikuese për pajisjet e testeve të shpejta, në vijueshmëri të përdorimit të tyre.</i> Menjëherë</p>	

Konkluzion

Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe referuar objektivave dhe qëllimit të projektit të Fondeve IPA 201(referencë faqe 34-41 e RPA) konkludojmë se objektivi, qëllimet dhe rezultatet e projektin IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” në lidhje me përfituesin AKU nuk janë përmbushur.

Aktualisht AKU nuk ka ende një Strategji të miratuar, nuk ka përfituar pajisje në atë masë që të mund të përmirësojë dukshëm nivelin e cilësisë së analizimit konform dhe funksioneve ligjore të sajë, përfshirë këtu dhe nivelin e pamjaftueshëm dhe jo themelor të bazës së temave trajnuese.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr 2016/1, datë 8.04.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH (person i deleguar), nga data 15.04.2019 deri në datën 17.05.2019, në subjektin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit periudhën nga data 1.01.2016 deri ne momentin e auditimit (viti 2019), u krye auditim përputhshmërie në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për projektin IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”.

” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. N. P, Përgjegjës Grupi
2. I. B, Audituese
3. M. B, Audituese
4. I.H, Auditues

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) auditoi Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) Tiranë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përfitimeve të AKU në drejtim të pajisjeve dhe trajnimeve në kuadër të implementimit të projektit IPA 2013, referuar objektivave dhe qëllimeve të projektit si dhe përmirësimin e funksioneve të AKU në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga ligjet në fuqi, referuar implementimit të këtij projekti dhe përfitimeve prej tij.

Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes dhe fakti i marrjes në dorëzim të pajisjeve të përfituara konform specifikimeve teknike e dokumentacionit shoqërues të tyre, regjistrimet dhe përdorimet konform legjislacionit në fuqi dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Çështjet e audituara si dhe drejtimet e auditimit janë :

1. *Kuadri ligjor i miratuar në lidhje me përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) në kuadrin e implementimit të fondeve IPA 2013 si dhe ndryshimet e tij gjatë implementimit. Përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit referuar kontratave të miratuara për përfituesin (listimeve të miratuara).*
2. *Komunikimet zyrtare në lidhje me përfitimet konkrete, opinionet e dhëna për draft raportet e paraqitura nga menaxhimi i projektit, apo dakortësitë mbi to.*
3. *Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrin rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2013 për përfituesin AKU.*
4. *Përdorimi me efektivitet i pajisjeve dhe trajnimeve të përfituara nga AKU pas periudhës së përfitimit, për kryerjen së funksioneve të saj konform kërkesave ligjore.*

Objektivat dhe qëllimi.Me auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, lidhur me realizimin e Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Për auditimin e përputhshmërisë, do të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, rregulloreve, politikave, kodeve, shoqëruar me dhënien e opinionit nëse të ardhurat nga granti në institucionin e AKU janë përfituar në përputhje me aktet e miratuara të grandit për termat e referencës dhe kontratat duke përfshirë regjistrimin e menaxhimin në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese për çështjet të cilat janë nën auditim është dhënia e mendimeve për çdo aktivitet dhe output të planifikuar dhe rezultuar nga aktiviteti përgjatë implementimit të projektit IPA 2013. Dhënia e mendimit dhe opinioneve të përfituesve është proces i rëndësishëm në implementimin e projektit me qëllim që përfitimet të jenë afër apo në përputhshmëri me nevojat, funksionet, kompetencat që kryen AKU në zbatim të ligjit dhe realizimin me efektivitet të objektivave dhe qëllimit të projektit.

Gjithashtu përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është regjistrimi ligjor, përdorimi me efektivitet dhe ligjor të përfitimeve, duke eliminuar kohën jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë së AKU, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore në fuqi, kuadri rregullator dhe metodologjik për të gjithë punonjësit e strukturës së laboratorëve duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë mbi përputhshmërinë, në bazë të auditimit tonë. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim, që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm që nuk është në nivelin e duhur, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e këtij institucioni publik.

Kriteret e vlerësimit. Projekt Raporti i Auditimit është kryer mbi bazën e legjislacionit kryesor si:
-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.

Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar. Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manual i Auditimit Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” u ndryshuar, Ligji nr. 9863 datë 28.01.2008 “ Për ushqimin “ i ndryshuar, Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 ”Për inspektimin” Termat e referencës për fondet IPA 2013 , etj.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1081 datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” i ndryshuar me V.K.M nr. 257 datë 06.03.2013.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Vlerësimi është bërë nga auditimi hap pas hapi të të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion, ku në memon e planifikimit dhe fondeve në dispozicion janë përcaktuar materialiteti dhe risku si dhe transaksionet për auditim ku periudha e zgjedhjes së auditimit të transaksioneve është përcaktuar sipas gjykimit të secilit auditues.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Autoriteti Kombëtar i ushqimit është institucion publik në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe ku parimet e përgjithshme, fusha e veprimit si dhe organet përbërëse të tij janë përcaktuar në nenet 61,62,63 të ligjit nr.9863, date 28.1.2008 “Për ushqimin” të ndryshuar.

AKU është person juridik publik buxhetor nën vartësinë e MBZHR dhe veprimtaria e tij financohet nga Buxheti i shtetit.

Ky institucion funksionon mbi bazën e legjislacionit si: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” u ndryshuar, Ligji nr. 9863 datë 28.01.2008 “ Për ushqimin “ i ndryshuar, Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 ”Për inspektimin”, Termat e referencës për fondet IPA 2013, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1081 datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” i ndryshuar me V.K.M nr. 257, datë 06.03.2013,etj.

Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e drejtimeve të auditimit në masë të konsiderueshme të transaksioneve, duke përfshirë të gjithë numrin e tyre dhe të raporteve të rezultuara gjatë periudhës së implementimit të projektit.

Objekt i këtij auditimi : Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, lidhur me realizimin e Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”

Qëllimi i auditimit:Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, rregulloreve, politikave, kodeve, shoqëruar me dhënien e opinionit nëse të ardhurat nga grandit në institucionin e AKU janë përfituar në përputhje me aktet e miratuara të grandit për termat e referencës dhe kontratat duke përfshirë regjistrimin e menaxhimin në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të Auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

1. Kuadri ligjor i miratuar në lidhje me përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) në kuadrin e implementimit të fondeve IPA 2013 si dhe ndryshimet e tij gjatë implementimit. Përfitimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit referuar kontratave të miratuara për përfituesin (listimeve të miratuara).

Në kuadër të implementimit të Projektit të financuar nga Programi IPA 2013: “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, rezulton se Agjencia Kombëtare e Ushqimit është pjesë e qenësishme dhe tepër aktive si përfituese e benefiteve të Projektit

Ky projekt paraqitet me këto të dhëna:

Financuar nga:

IPA 2013- Komisioni Evropian

Kosto e projektit:

2.6 mln €

Data e fillimit të projektit:

Korrik 2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Kohëzgjatja:

36 muaj

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM i këtij projekti 3-vjeçar është të lehtësojë dhe mbështesë kapacitetet administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

OBJEKTIVAT SPECIFIKËtë projektit janë:

-Ngritja e një rrjeti laboratorik me kosto efektive të aftë për të siguruar informacion të besueshëm dhe në kohë për sigurinë e ushqimit dhe shëndetit të kafshëve dhe,

-Përmirësimi i kapacitetit të rrjetit laboratorik për të kryer monitorimin dhe analizën e ushqimit dhe produkteve ushqimore me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnostikimin mikrobiologjik në ushqim dhe ushqim për kafshe, standardet e cilësisë së ushqimit, sëmundjet e kafshëve, në përputhje me përmirësimin e standardeve kombëtare

Aktualisht, institucionet dhe agjencitë e përfshira në menaxhimin e sigurisë së ushqimit, në Shqipëri janë:

1. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me drejtoritë e saj:

- Drejtoria e Sigurisë Ushqimore me strategjitë dhe legjislacionin për sigurinë e ushqimit, cilësinë e produkteve ushqimore dhe çështjet e mbrojtjes së bimëve;

- Drejtoria e Veterinarisë që mbulon shëndetin e kafshëve;

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinës si laborator kombëtar reference;

- Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë që mbulojnë çështjet e veterinarisë dhe fito sanitarit në nivel rajonal.

2. Qeveritë lokale kryesisht të përfshira në çështjet veterinarë si lëvizja e kafshëve, tregjet e kafshëve

3. Instituti i Shëndetit Publik që mbulon çështjet e higjienës së ujit të pijshëm.

4. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me 11 laboratorët e sigurisë ushqimore, 11 laboratorët e shëndetit të kafshëve dhe 7 laboratorë të shëndetit të bimëve. Analizat kryesore të kryera në sigurinë ushqimore bëhen me metodat fizike/kimike, metodat mikrobiologjike.

Sistemi i rrjetit laboratorik duhet të kryejë analizat e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit. Duke ndjekur informacionet e ofruara nga studimi bazë financiar nga një projekt i mëparshëm i IPA-s ku rezultoi nevoja për të kryer një reformë të rëndësishme në sistemin e laboratorit dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të saj për të siguruar informacion të besueshëm për rreziqet e lindura të ushqimit.

Një politikë e tillë mund të kërkojë që shumica e laboratorëve rajonalë të kryejnë matje të thjeshta bazë të bëra nga shqyrtimi dhe testet e shpejtë diagnostikuese, ndërsa konfirmimi do të kryhet në laboratorët referencë.

Për këtë nga ekspertët të projektit janë bërë vizita për të identifikuar gjendjen e rrjetit të laboratorëve dhe nevojave për pajisje të tyre. Referuar gjendjes së identifikuar nga ekspertët është përcaktuar një listë fillestare e pajisjeve të nevojshme e cila është dakordësuar nga AKU dhe dërguar me propozimet përkatëse në lidhje me mënyrën e organizimit të AKU. Referuar vendimmarrjes përfundimtare ka rezultuar se kjo listë fillestare është pakësuar në disfavor të AKU duke pakësuar numrin e DRAKU–ve përfituese nga 5 në 3 për rrjedhojë dhe numrin e pajisjeve të përfituara.

Vlen për tu përmendur se ky numër i pajisjeve të përfituara është pakësuar edhe si rezultat i mosrealizimit të tenderit për pajisjet e Lotit 2, që paraqesin pajisjet laboratorike për përcaktimin e parametrave mikrobiologjik në lëndët ushqimore, për testimin mikrobiologjik të molekulave. AKU nuk përfiton asnjë pajisje nga ky LOT. Në faqen zyrtare të Komunitetit Evropian është dhënë ky koment për arsyen e anulimit: “mungesë fondesh për shkak të skadimit të afatit të kontratës për Programin Kombëtar IPA 2013 gjatë procesit të vlerësimit të Lotit 2 “Testimi Mikrobiologjik”. Autoriteti Kontraktor nuk do të rifillojë tenderin për Lotin 2.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Sa cituam mësipër në aneksin nr.1 (bashkëlidhur materialit) jepen në mënyrë analitike pajisjet e listuara si nevojë e laboratorëve të AKU, pajisjet e dizenuara për tenderim dhe ato të përfituara nga kontraktimi dhe ku në mënyrë të përmbledhur për secilin LOT paraqesim:

Emërtimi i pajisjeve për LOTIN 3	Përcaktuar nevojat nga inspektimi me ekspertë të huaj					Totali	Tenderuar			Total	Realizuar			Totali
	Tiranë	Durrës	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		Korçë	Shkodër	Gjirokastrë	
Shuma totale e pajisjeve për çdo laborator	0	2	12	11	8	33	12	12	8	32	12	12	8	32

Emërtimi i pajisjeve për LOTIN 1	Përcaktuar nevojat nga inspektimi me ekspertë të huaj					Total	Tenderuar			Total	Realizuar			Total
	Tiranë	Durrës	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		Korçë	Shkodër	Gjirokastrë	
Shuma totale e pajisjeve për çdo laborator	4	3	5	5	5	22	5	5	5	15	5	5	5	15

Sa pasqyruar në tabelë për **Lotin 1** nga 22 pajisje të identifikuara për 5 laboratorë, është tenderuar dhe realizuar furnizimi me 15 pajisje për 3 laboratorë.

Emërtimi i pajisjeve për LOTIN 2	Përcaktuar nevojat nga inspektimi me ekspertë të huaj					Totali	Miratuar për tu tenderuar			Totali	Realizuar			Totali
	Tiranë	Durrës	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		Korçë	Shkodër	Gjirokastrë		korçë	Shkodër	Gjirokastrë	
shuma totale e pajisjeve per cdo laborator	4	2	18	17	17	58	19	19	18	56	0	0	0	0

Sa pasqyruar në tabelë për **Lotin 2** nga 58 pajisje të identifikuara të nevojshme për 5 laboratorë, janë miratuar si listim 56 pajisje për 3 laboratorë, ku tenderimi nuk është realizuar dhe për rrjedhojë AKU nuk ka përfituar asnjë pajisje nga ky Lot.

Sa pasqyruar në tabelë për **Lotin 3** nga 33 pajisje të identifikuara të nevojshme për 5 laboratorë, janë miratuar si listim 32 pajisje për 3 laboratorë dhe është realizuar tenderimi dhe furnizimi për 32 pajisje për 3 laboratorë të AKU-së.

Emërtimi i pajisjeve për LOTIN 4	Përcaktuar nevojat nga inspektimi me ekspertë të huaj	Tenderuar			Realizuar		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

	Tiranë	Durrës	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë	Totali	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë	Totali	Korçë	Shkodër	Gjirokastrë	Totali
Shuma totale e pajisjeve për çdo laborator	4	2	2	2	2	12	2	2	2	6	2	2	2	6

Sa pasqyruar në tabelë për **Lotin 4** nga 12 pajisje të identifikuar të nevojshme për 5 laboratorë, janë miratuar si listim 6 pajisje për 3 laboratorë dhe është realizuar tenderimi dhe furnizimi për 6 pajisje për 3 laboratorë të AKU-së.

Me fondet IPA 2019 janë kryer kontraktime për përfituesit për blerje pajisjesh si më poshtë vijon:

-Kontrata “Furnizim për laboratorët ushqimorë në Drejtorinë rajonale ISFV dhe NFA”

Vlera e Kontratës Total: 1,937,593 Euro, nga të cilat IPA: 1,608,202 Euro dhe Buxheti i Shtetit: 329,390 Euro

Kontraktori: E. Ltd

Lot 1: 457,973 Euro, nga të cilat IPA: 380,117 Euro dhe Buxheti i Shtetit 77,855 Euro

Data e nënshkrimit të kontratës: 27.11.2017

Data e përfundimit të kontratës: 15.10.2018

Kontraktori: P. Ltd

Lot 3: 271,614 Euro, nga të cilat IPA: 225,440 Euro dhe Buxheti i Shtetit 46,174 Euro

Data e nënshkrimit të kontratës: 27.11.2017

Data e përfundimit të kontratës: 20.08.2018

Kontraktori: P. Ltd

Lot 4: 1,208,005 Euro, nga të cilat IPA: 1,002,644 Euro dhe Buxheti i Shtetit 205,360 Euro

Data e nënshkrimit të kontratës: 27.11.2017

Data e përfundimit të kontratës: 30.07.2018

Mbi pajisjet e pa përfituara nga dështimi i realizimit të tenderimit të Lotit nr.2

Loti 2, Mikrobiologjia Ushqimore.

Qëllimi i lotit 2 ishte “forcimi i seksioneve të testimit mikrobiologjik në DRAKU përfituese, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve”.

Pajisjet e përcaktuara, por të pa përfituara, në total 56 pajisje ose 17 lloje pajisjesh që ishin parashikuar të bliheshin në lotin 2, janë:

-Pajisja MBT_1 (Vertical floor standing Autoclave for sterilization of media at least 75 litres) shërben për sterilizimin e pajisjeve laboratorike të ndryshme.

-Pajisja MBT_2 (Hot air sterilizer for sterilization of glassware with capacity of 110 litres and maximum temperature 250 °C) shërben për sterilizimin e pajisjeve, kryesisht prej qelqi në laboratorët e përfitues.

-Pajisja MBT_3 (pH meter) shërben për matjen matjen e aciditet (përqëndrimit të joneve hidrogjen në tretësirë) të mostrave të lëngta.

-Pajisja MBT_4 (Water Bath ambient temperature +5°C to 95°C, 12 litres), e quajtur ndryshe Banjo Mari, shërben për mbajtjen e temperaturës konstante për një kohë të gjatë, të krijoj kushte optimale për analizat që duan temperaturë të zhvillohen

-Pajisja MBT_5 (Refrigerators/Freezers 2/-20°C, 295 litre overall capacity) shërben për ruajtjen e produkteve në ftohje ose ngrirje, sipas kërkesave.

-Pajisja MBT_6 (Laboratory Refrigerators with capacity 600 litre) ftohës për laborator, që shërben për mbajtjen e produkteve në gjendje të freskët.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

- Pajisja MBT_7 (*Laminar flow cabinet 1800mm width, with stand, UV sterilization and HEPA filter*) shërben si vend eksperimental, i mbrojtur, me sterilizim dhe filtrim ajri.
- Pajisja MBT_8 (*Hot plate magnetic stirrer*) shërben si ngrohës dhe përzjerës magnetik, për mostrat që analizohen.
- Pajisja MBT_9 (*Technical balance 0.01g, capacity 3000g*) peshore teknike deri në 3kg, dhe saktësi $\pm 0.01g$.
- Pajisja MBT_10 (*Microbiological incubator, capacity 80 litre*) shërben për mbajtjen dhe zhvillimin e analizave mikrobiale në temperaturë të kontrolluar.
- Pajisja MBT_12 (*Distilled Water Device, for single distillation with storage tank (reservoir), producing at least 4 litre per hour, single distilled water with conductivity $3\mu S\text{cm}^{-1}$*) shërben për të prodhuar ujë të distiluar për nevoja të laboratorit.
- Pajisja MBT_13 (*Microbiology paddle blender (stomacher type) with bag and bag rack (maximum volume 400ml)*) grirës i tipit stomak.
- Pajisja MBT_14 (*Colony counter, manual use*) shërben për numërimin e kolonisë bakteriale në njësi sipërfaqe qumështi.
- Pajisja MBT_15 (*Digital vortex mixer*) shërben për përzjerjen e produkteve të lëngëta.
- Pajisja MBT_16 (*6 places Vacuum Filtration manifold, stainless steel with 6 filter holders, escorted with vacuum pump*) shërben për filtrimin në vakum, në analiza gravimetrike.
- Pajisja MBT_17 (*Adjustable automatic pipettes 100-1000 μ l*) shërben për titrime specifike.
- Pajisja MBT_19 (*Laboratory blender at least 2 litres capacity with stainless steel container, with variation rotation speed up to 17,000 rotation per minute*) shërben për grirjen (bluarjen) e mostrave të analizueshme, para analizimit të tyre.

Konkluzion i grupit të auditimit:

Këto pajisje do të shkonin në 3 laboratorët mikrobiologjik përfitues (DRAKU Korçë, Shkodër, Gjirokastrë). Vetëm tre nga pajisjet ishin për qëllimin e analizave mikrobiologjike: MBT_10 (Microbiological incubator, capacity 80 litre), Pajisja MBT_14 (Colony counter, manual use) dhe MBT_13 (Microbiology paddle blender (stomacher type) with bag and bag rack (maximum volume 400ml),

Pajisjet e tjera ishin pajisje ndihmëse dhe të përdorshme për çdo laborator.

2. Komunikimet zyrtare në lidhje me përfitimet konkrete, opinionet e dhëna për draft raportet e paraqitura nga menaxhimi i projektit, apo dakortësitë mbi to.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si një nga institucionet përfituese e fondeve të alokuara nga BE për projektin IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, për çdo draft raport të paraqitur nga menaxhimi i Projektit përmes SPO, ka dhënë komentet e saj për problematikat e ndryshme të diskutuara gjatë fazës së implementimit të projektit *cilat paraqiten gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit*. Në kuadër të implementimit të projektit IPA 2013 janë kryer aktivitete për të realizuar outpute. Referuar realizimit të veprimtarive në këtë kuadër nga menaxhimi paraqiten raporte për të cilat merret dhe opinionin dhe dakortësitë e pjesëmarrësve në këto aktivitete, si dhe përfituesve.

Referuar raporteve dhe përgjigjeve dhe komenteve të dhëna nga stafi i AKU (trajtime të realizuara gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit) si dhe komenteve në minuatat e takimeve të Komitetit Drejtues, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin sa më poshtë:

1. Referuar raporteve mujore të paraqitura dhe të analizuara, strategjia dhe struktura janë propozuar në fazat e mëvonshme të Projektit (datë 19.12.2018, dokumenti “Letër Pune 29”), në një kohë që referuar aktiviteteve të miratuara për implementimin e projektit, miratimi i tyre si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

dokumente strategjie duhej t'i paraprinte furnizimit me pajisje dhe realizimit të trajnimeve të stafit laboratorik. Edhe në momentin e këtij auditimi nuk ka vendimmarrje përfundimtare për strategjinë.

2. Nuk është marrë në konsideratë mendimi dhe parashikimet e AKU duke u fokusuar në fushë veprimtarinë e tyre referuar pozicionit rajonal, dhe funksioneve të miratuara në ligjin "Për Ushqimin" nr.9863, datë 28.01.2008 i ndryshuar, neni 38 dhe 39, në mënyrë që laboratorët e AKU të funksionojnë si laboratorë të autorizuar kontrolli në përputhje dhe me funksionet dhe vijueshmërinë e aktiviteteve të AKU të përcaktuar në nenin 62 të po këtij ligji. (raporti mujor Shkurt 2017)

3. AKU nuk ka qenë pjesë e përcaktimeve të listës finale të pajisjeve të nevojshme dhe specifikimeve të pajisjeve të listuara. Në lidhje me këtë përcaktim nuk janë marrë në konsideratë opinionet e saj në lidhje me pajisjet e nevojshme për rrjetin e laboratorëve të AKU.

4. AKU nuk i është vënë në dispozicion dokumenti i hartuar për raportimin për sigurinë dhe kontrollin ushqimor ligjor, si dhe harmonizimin e tij me legjislacionin dhe procedurat e BE.

5. Gjithashtu nuk i janë vënë në dispozicion vlerësimet e rregullimeve në fushën e standardeve ushqimore, infektimit, mbetjeve, si dhe përshtatshmërinë e tyre në lidhje me legjislacionin dhe procedurat e BE.

6. AKU referuar komenteve të raportimeve mujore nuk ka qenë pjesë e përcaktimit të temave të trajnimit të stafit të laboratorëve. Nga ana e AKU në disa raste është insistuar për realizimin e disa temave të domosdoshme, për të cilat është kontaktuar direkt me ekspertët e projektit; dhe këto tema janë realizuar.

7. Referuar dokumentit "Letër Pune 29" ku propozohet mënyra e organizimit të rrjetit laboratorik, në propozimin e paraqitur rrjeti laboratorik i AKU do të jetë i organizuar në dy nivele:

-laboratorë primarë qendrorë të kontrollit zyrtar,

-si dhe gjashtë laboratorë rajonalë të kontrollit, të pajisur me pajisje analizatorë të shpejtë multi-parametrikë, në mënyrë që të kryejnë "teste të shpejta" fiziko-kimike për cilësinë ushqimore; si dhe të gjitha standardet parametrike të testeve mikrobiologjike dhe bakteriologjike (shëndeti i kafshëve) dhe shëndetit bimor.

Referuar këtij propozimi për organizimin e nivelit të laboratorëve dhe përfitimeve deri në momentin e këtij auditimi, në kuadër të projektit IPA 2013 konkludojmë:

a-Për laboratorët primarë qendrorë të kontrollit zyrtar, nuk ka financim as në pajisje, as trajnime për t'u përshtatur në kontekstin e strategjisë së propozuar dhe objektivat e projektit.

b-Për gjashtë laboratorët rajonalë të propozuar, përfitimet nga projekti në pajisje kanë qenë vetëm në tre prej tyre (Korça,Shkodra,Gjirokastra), me pajisje të Loteve 1, 3 dhe 4; ku përzgjedhja e këtyre laboratorëve nuk ka një studim lidhur me:

-numrin e mostrave të analizuara nga secili laborator,

-kategori matricash (kategori e analizave),

-infrastruktura,

-stafi,

-afërsia me pikat e inspektimit kufitar dhe pikun e tyre.

Mbështetur në materialet sa mësipër cituam, krahasuar me objektivat dhe qëllimin e projektit rezulton se përfitimet e AKU pjesë e institucioneve përfituese në kuadrin e implementimit të Projektit IPA 2013 "Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

veterinarisë në Shqipëri” janë të një niveli shumë të pamjaftueshëm për të arritur sigurinë ushqimore apo për të kryer funksionet e këtij institucioni konform ligjit.

3. Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrin rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit. Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2013 për përfituesin AKU.

Vështrim i përgjithshëm

Në dokumentin e termave të referencës së projektit IPA 2013

“Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, paraqitet Strategjia aktuale kombëtare e zhvillimit rural në Shqipëri, që është "Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural " për periudhën 2014-2020 dhe që përcakton vizionin e mëposhtëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural:

-Sektori agro-ushqimor efikas, inovativ dhe i zbatueshëm, i aftë për të mbështetur presionin konkurrues dhe përmbushjen e kërkesave të tregut të BE-së përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve.

-Zonat rurale që sigurojnë aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi të jetës për banorët ruralë.

Kjo do të arrihet duke lehtësuar ristrukturimin e sektorit bujqësor, duke përmirësuar përdorimin e tokës dhe duke forcuar orientimin dhe pjesëmarrjen e tregut me një fokus të veçantë në rivendosjen, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve të varur nga bujqësia dhe pylltaria.

Bazuar në objektivat strategjike për periudhën 2014-2020, një plan i detajuar i veprimit që përfshin prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitar do të synojë në ndërtimin e kapaciteteve që do të sigurojnë harmonizimin e plotë dhe zbatimin e tërësisë së rregullave, procedurave e udhëzuesve (acquis) të BE .

Aktivitetet kryesore përfshijnë (i) ndryshimet në kuadrin ligjor, (ii) forcimi i kapaciteteve të zbatimit të ligjit, (iii) përmirësimi i rrjetit laboratorik, (iv) forcimi i kapaciteteve të administratës publike, (v) përmirësimi i sistemeve të informacionit , (vi) përcaktimi i gjurmueshmërisë në të gjithë zinxhirin

Aktualisht, në projektin IPA 2013 do të jenë pjesë institucionet dhe agjencitë e përfshira në menaxhimin e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare në Shqipëri, ku bën pjesë dhe Rrjeti i laboratorëve ku pjesë është dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Nën këtë Autoritet funksionojnë 11 laboratorë të sigurisë ushqimore, 11 laboratorë të shëndetit të kafshëve dhe 7 laboratorë të shëndetit të bimëve, që punojnë në nivel lokal nën autoritetin e AKU, ku aktualisht gjendja e tyre paraqitet:

1. Rrjeti i laboratorit përballet me probleme të ndryshme të natyrës teknike, administrative dhe financiare;

2. Ka mungesë të metodave standarde dhe të shpejta të analizave siç janë testet biokimike ose testet imunologjike që shërbejnë për një gamë të gjerë aplikimesh, përfshirë histamine, aflatoksinë, mikroorganizmat patogjene, mbetjet e ndryshme në ushqime etj;

3. Ekziston mungesa e validimit të metodës së testimit në laboratorë;

4 Ka mungesë të lehtësirave për transportin dhe ruajtjen e mostrave;

Një numër i laboratorëve kanë pajisje të thjeshta dhe të vjetruara të përdorura për analiza klasike dhe disa rutinë që nuk mund të përdoren për një spektër më të gjerë të analizës bazë. Inventari aktual i pajisjeve nuk siguron mbulim të plotë të metodave ekzistuese analitike dhe diagnostike ose nga mungesa e qartë e ndarjes së detyrave ose nga mungesa e mirëmbajtjes dhe zëvendësimi i pajisjeve të amortizuara.

5. Nuk ka shërbim mirëmbajtjeje dhe riparimi për pajisjet jo funksionale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

6. Siguria në punë në shumë laboratorë është e pakënaqshme për shkak të mungesës së pajisjeve të posaçme si kabine të fume apo kabine biologjike. Pothuajse të gjithë laboratorët nuk kanë pajisje të përdorura në analizat mikrobiologjike,
7. Metodat për testet fizike / kimike të disponueshme në të gjitha laboratorët i referohen standardeve shqiptare të vitit 1987, të cilat duhet të jenë të përditësuara me teknika më të
8. Shumë kontrole fito-sanitare bëhen kryesisht në kulturat bujqësore ose materiale mbjellëse në lidhje me shëndetin e bimëve dhe bazohen në vëzhgimet vizive dhe përcaktimin e thjeshtë mikroskopik. Nuk ka kontrole për produktet e depozituara apo të importuara në lidhje me prezencën e patogjenëve dhe për pasojë nuk ka analiza në lidhje me zbulimin e mykotoksinave të shoqëruara me grurë, silazh dhe ushqime të tjera të kafshëve.
9. Kontrollat veterinarë i referohen sëmundjeve shumë pak, si antraksi, bruceloza ose enterotoksemia, me kapacitetin diagnostik të mbetur të ulët. Edhe pse e pranishme në vend, sëmundjet parazitare siç janë p.sh. fluke nuk regjistrohen nga librat laboratorikë. Përveç kësaj, nuk ka asnjë pajisje për të kryer nën kopjen e kafshëve të ngordhura për të marrë ekzemplarë për analiza të mëtejshme në laboratorin kombëtar.
10. Personeli mund të konsiderohet i përshtatshëm edhe pse shumë i ngarkuar. Megjithatë, ekspertiza e tyre duket e kufizuar për shkak të mungesës së trajnimit me metoda dhe teknika të azhurnuara;
11. Masat e kufizuara të kontrollit të brendshëm të cilësisë aplikohen në cilindo nga laboratorët dhe kalibrimi i pajisjeve pothuajse mungon;
12. Një problem serioz është dhe konstatimi i mungesave të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e mbetjeve laboratorike në përgjithësi. Nuk kishte procedura të shkruara standarde për deponimin e gjakut, serave, mostrave të indeve, rrëshqitjeve mikroskopike të përdorura, instrumenteve të mprehta, shiringave, gjilpërave dhe kulturave bakteriale etj. Shumica e laboratorëve nuk kishin objekte të duhura për deponimin e sigurisë dhe menaxhimin e mbeturinave.
13. Laboratorët vuajnë nga mungesa e konsumit dhe reagentëve të nevojshëm që furnizohen në sasi të pamjaftueshme dhe diku vonë;
14. Ekziston një sërë analizash laboratorike që nuk janë kryer në laboratorë duke përfshirë aditivët, alergenët, disa ndotës dhe patogjenë.

Për sa më sipër Objektivi i përgjithshëm i projektit, që do të jetë pjesë e kësaj kontrate, është të mbështesë kapacitetet administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

Dhe ku qëllimi i projektit do të jetë:

1. Ngritja e një rrjeti laboratorik me kosto efektive që është në gjendje të ofrojë informacion të besueshëm dhe në kohë për sigurinë e ushqimit të shitur dhe shëndetin të kafshëve, dhe
2. Rritja e kapacitetit të rrjetit laboratorik për kryerjen e monitorimit dhe analizës së ushqimeve dhe prodhimit të ushqimit me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnostikimit mikrobiologjik në ushqim dhe produktet ushqim, standardet e cilësisë së ushqimit, sëmundjet e kafshëve, në përputhje me përmirësimin e standardeve.

Në kuadër të implementimit të Projektit IPA 2013 tre drejtori rajonale të AKU kanë qenë përfituese të disa pajisjeve laboratorike referuar lidhjes së kontratave për tre lote (Loti 1,3,4).

Drejtoritë Rajonale përfituese (laboratorët e tyre) dhe pajisjet e përfituara nga secila prej tyre paraqiten në tabelat si më poshtë vijon:

LOT 1: Food quality

Category of Equipment		Description of Equipment	NFA		
			Gjirokastër	Korça	Shkoder



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Food quality	1	MPA_1	Milk and milk products multiparametric analyser	1	1	1
	2	MPA_2	NIR Food multiparametric analyser	1	1	1
	3	MPA_3	NIR multiparametric analyser for Grain, Cereals, Seeds and flour (Moisture, Protein, Oil, ash, hectoliter weight, etc)	1	1	1
	4	MPA_4	Fluorescent microscopic Somatic Cell Counter	1	1	1
	5	MPA_5	NIR Wine and Spirits multiparametric analyser	1	1	1
TOTAL				5	5	5

LOTI 3 Animal health

Category of Equipment			Description of Equipment	NFA		
				Gjirokastër	Korçë	Shkodër
Animal health - Regional laboratories	10	AHR_1	Analytical balance 1mg, capacity at least 400 g		1	1
	11	AHR_2	Water Bath, Ambient +5°C to 95°C, capacity at least 8 liters	1	1	1
	12	AHR_3	Adjustable automatic pipettes 100-1000 µl	2	2	2
	13	AHR_4	Microscope with a high-resolution at least 3 megapixel digital camera		1	1
	14	AHR_5	Benchtop centrifuge with rotor for at least 8X15 ml tubes and 4X50 ml tubes, maximum speed at least up to 3.900 rpm		1	1
	15	AHR_6	Colony Counter, manual use	1	1	1
	16	AHR_7	Hot plate-Magnetic Stirrer	1	1	1
	17	AHR_8	Vortex Mixer	1		1
	18	AHR_9	Microbiological Incubator, capacity 80 litre		1	
	19	AHR_10	Refrigerators/Freezers 0/-20°C with at least 295 lt overall capacity		1	1
General	20	G_1	UPS station (6000 VA)	1	1	1
	21	G_2	Digital reference thermometer - thermocouple PT100	1	1	1
TOTAL				8	12	12

LOT 4: Pesticide residues

Category of Equipment			Description of Equipment	NFA		
				Gjirokastra	Korçë	Shkodër
Pesticide residues in plant foodstuffs, aflatoxins and heavy metals testing - FSVI	1	PCT_1	Ductless Chemical Fume Hood (at least 1500 mm width)	1	1	1
	10	PCT_10	Aspirated and Filtered Safety Cabinets for storage of chemicals (acids and bases), min external width 1190 mm, min height 1900 mm	1	1	1
TOTAL				2	2	2

Procedura e marrjes në dorëzim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Për marrjen në dorëzim të pajisjeve sa më sipër parashikuar për tre laboratorët e drejtorive rajonale të autoritetit Kombëtar të Ushqimit: Korçë, Shkodër, e Gjirokastrë me shkresën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 5978, datë 25.06.2018 “Kërkesë për ngritjen e Grupeve të marrjes në dorëzim të pajisjeve të Laboratorëve për Lotin 1, Lotin 3 dhe Lotin 4” nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë kërkohet propozimi i grupeve të marrjes në dorëzim të veçanta për secilën drejtori rajonale me anëtarë që të kenë kapacitetet teknike dhe administrative për kryerjen e procesit dhe ku grupet e punës do të analizojnë përputhshmërinë e pajisjeve të dorëzuara nga kontraktori me specifikimet teknike dhe ofertën teknike si pjesë e kontratës.

Nga MBZHR i është dërguar DRAK Korçë, Shkodër, e Gjirokastrë urdhrat e Ministrit përkatësisht me nr.327, 326, 326, datë 30.07.2018 me protokoll përkatësisht nr.7858/3, 7858/2,7858/1, datë 30.07.2018. Urdhrat kanë datën e hyrjes në AKU 7.08.2018 .

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë Rajonale të AKU Korçë (procedura e marrjes në dorëzim)

Nga auditimi ka rezultuar:

Për Lotin 3

Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim është mbajtur nga grupi i ngritur me urdhrin e ministrit nr.327, datë 30.07.2018 i përbërë nga :

1. Z. Dh.P, Përgjegjës ne Sektorin e Shërbimeve Laboratorike, DRAKU Korçë
2. Znj. J. Sh, Përgjegjëse ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Korçë
3. Z. K. L, Specialist ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU-Korçë
4. Z. A. A, Specialist ne Sektorin e Veterinarisë dhe Mirëqenies se kafshëve, MBZHR nuk ka firmosur pasi është larguar nga detyra
5. Z. N. P, Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Programeve te Zhvillimit ne Fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, MBZHR,

me datën 12.11.2018, të cilët kanë konfirmuar për ardhjen e sasive të pajisjeve dhe pjesëve përbërëse të përcaktuara për DRAKU Korçë tek loti 3 (për pajisjet, pjesët e këmbimit, materialet e konsumueshme sipas parashikimit të kontratës). Gjithashtu në aktin e marrjes në dorëzim të përkohshëm nga grupi i marrjes në dorëzim citohet se:

“Gjate verifikimit u identifikua se te gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori.... Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Pajisjet janë shoqëruar me manualët përkatëse dhe pjesët e këmbimit duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në kontratë.”

Grupi i auditimit verifikoi listën e pajisjeve të pritura (ardhura) dhe pjesëve të tyre, me ekzistencën fizike të tyre në ambientet e instaluar, nga ku rezultoi se nuk u paraqitën deviacione (chek lista loti 3 bashkëlidhur projekt raportit Aneksi 2)

Për Lotin 4

Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim është mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim:

1. Z. Dh. P, Përgjegjës ne Sektorin e Shërbimeve Laboratorike, DRAKU Korçë
2. Znj. J. Sh, Përgjegjëse ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Korçë
3. Z. K. L, Specialist ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU-Korçë
4. Z. A. A, Specialist ne Sektorin e Veterinarisë dhe Mirëqenies se kafshëve, MBZHR nuk ka firmosur pasi është larguar nga detyra
5. Z. N. P, Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Programeve te Zhvillimit ne Fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, MBZHR,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

me datën 12.11.2018, të cilët kanë konfirmuar për ardhjen e sasive të mallrave të përcaktuara për DRAKU Korçë në lotin 4 (për pajisjet, pjesët e këmbimit, materialet e konsumueshme sipas parashikimit të kontratës). Gjithashtu në aktin e marrjes në dorëzim të përkohshëm nga grupi i marrjes në dorëzim citohet se:

“Gjate verifikimit u identifikua se të gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori.... Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Pajisjet janë shoqëruar me manualët përkatëse dhe pjesët e këmbimit duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në kontratë.”

Grupi i auditimit verifikoi listën e pajisjeve të pritura (ardhura) dhe pjesëve të tyre, me ekzistencën fizike të tyre në ambientet e instaluar, nga ku rezultoi se nuk u paraqitën devijacione (chek lista loti 4 bashkëlidhur projekt raportit Aneksi 2).

Për Lotin 1

Procesverbalit është mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim dhe është konfirmuar me datën 12.12.2018 nga

1. Z. Dh. P,
2. Znj. J. Sh, 3. Z. K. L, 4. Z. N. P, përfaqësues i MBZHR,

Në këtë procesverbal janë cituar:

Verifikimi:

“Gjate verifikimit u identifikua se të gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike (përfshirë dhe Urdhrin Administrativ për pajisjen nr.1) dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori si dhe shumica e tyre janë vënë në përdorim të përditshëm. Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Për pajisjet nr.2, nr.3 dhe nr.5 gjatë trajnimit të zhvilluar u evidentuan pasaktësi në matje, të cilat lidhen me nevojën e axhustimit të tyre (sqaruar në shënimin më poshtë). Pajisjet janë shoqëruar me manualët përkatëse dhe pjesët e këmbimit dhe materialet e konsumueshme”.

Në shënim citohet:

“ Në lidhje me pajisjet NIR (2,3,5) me qëllim nxjerrjen e saktësisë së rezultateve nevojitet axhustimi i tyre në përputhje me metodat e referencës. Aktualisht sipas kërkesës së specifikimeve teknike dhe kontratës, kjo nevojë nuk është parashikuar për tu zhvilluar nga Kontraktori. Me qëllim funksionimin sa më të mirë të pajisjes u dakordësua në takime të përbashkëta mes kontraktorit, ISUV (si laborator reference) dhe 3 DRAKU që axhustimi i pajisjeve të realizohet nga ISUV me mbështetjen e kontraktorit për disa produkte dhe parametra të dakordësuar mes palëve”.

Sa mësipër cituar në shënimin e procesverbalit, grupi i marrjes në dorëzim ka dalë jashtë kontekstit të detyrimit të përcaktuar në urdhrin e ministrit nr.327, datë 30.07.2018, ku në pikën 3 citohet:

“Grupi i punës do të kryejë verifikimin e pajisjeve të dorëzuara nga kontraktori në përputhje me Specifikimeve teknike, ofertën teknike dhe materialet mbështetëse të cilat janë pjesë e kontratës. Gjithashtu ai do të verifikojë përmbushjen e rregullit të origjinës të pajisjeve të dorëzuara”.

Nga shpjegimet e bëra si dhe imelet e vëna në dispozicion nga përfaqësues të grupit të marrjes në dorëzim të DRAKU Korçë, rezultoi se drafti i procesverbalit të marrjes së përkohshme në dorëzim është përgatitur nga zyrtar i lartë i programit SPO, i cili ka ndikuar në marrjen e aparaturave në dorëzim, meqenëse kalonte afati final i dorëzimit të tyre me kushtin e specifikuar në aktin e marrjes në dorëzim, me pretendimin e rënies dakord nga të gjitha palët. (kontraktor, ISUV, AKU, SPO)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Aktualisht grupi i auditimit referuar gjithë korespondencës së vënë në dispozicion si dhe krahasimit të specifikimeve teknike të tenderit dhe atyre të ofruara krahasuar me gjendjen aktuale të tre pajisjeve, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

1. Pajisjet vazhdojnë dhe në momentin aktual të jenë jashtë funksioneve të tyre dhe nuk përdoren për faktin e mos nxjerrjes së analizave korrekte.

Për këtë sqarojmë se në DRAKU Korçë pajisjet kanë ardhur fillimisht në 27 Qershor 2018. Mbas verifikimit nga grupi i marrjes në dorëzim me dokumentacionin specifikime teknike të tenderit dhe ofertës së paraqitur nga Kontraktori P. dhe E. rezultoi se pajisjet e Lotit 1 si: 1. Spectra Alyzer, 1.Grain, 2.Food, 3.Vine & Spiritues ishin në mungesë totale të parakalibrimeve dhe jo në përputhje me specifikimet teknike (nuk matnin të gjithë parametrat për të gjithë gamën e produkteve të përcaktuar në specifikimet teknike. Pas refuzimit dhe kthimit mbrapsht të tyre, këto pajisje u risollën në DRAKU Korçë në fund të muajit Gusht 2018 me pretendimin e realizimit të kalibrimit të tyre dhe përfshirjen e gamës së parametrave të nxjerrë për produkt referuar pretendimeve të paraqitura nga grupi i marrjes në dorëzim.

Aktualisht tre pajisjet nuk janë gati për tu përdorur as në momentin aktual.

Në ofertën e paraqitur nga Kontraktori E.për këto pajisje theksohet se të gjitha kalibrimet për të gjitha parametrat janë përfshirë në aparatura. (dokumenti i lotit 1. Aparatura 2,3,5) Aktualisht nga testimet e kryera ka rezultuar se kalibrimet dhe parametrat e përfshira në to janë shumë më pak se sa kërkohet në dokumentet e tenderit duke theksuar veçanërisht Spectra Alyzer Grain, Spectra Alyzer Food të cilat janë në kundërshtim me specifikimet e tenderit.

Rënia dakord e SPO (në takimin midis palëve kontraktues, menaxhus projekti,përfitues, ekspert projekti) në lidhje me axhustimin dhe kalibrimin e parametrave nga ISUV në bashkëpunim me kontraktin, është një zgjidhje jo ligjore, jo në përputhje me të gjitha kërkesat e specifikimeve të tenderit, ku për pajisjet kërkohen analizimi i shumë produkteve dhe shumë parametrave për secilin produkt me qëllim bërjen e analizave produktive, dhe efektive në drejtim të sigurisë ushqimore (pra rritur gamën e analizimit jo vetëm në drejtim të shpejtësisë po dhe cilësisë) ku ky ishte dhe qëllimi i financimit të projektit dhe jo qëndrim në të njëjtin stad aktual. Gjithashtu detyrimi i furnizimit të pajisjeve të gatshme për punë, pra kryerjen e analizave të sakta gjatë testimit të vënies në punë nga kontraktori, referuar akteve ligjore në fuqi është i kontraktorit(furnizuesit). Veprimet sa mësipër bien në kundërshtim me ligjin nr.9875, datë 14.2.2008, "Për metrologjinë", të ndryshuar, neni 25 ku ndër të tjera citohet: " 2. Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar është përgjegjësi e furnitorit. Verifikimi fillestar ka të bëjë me kontrollin e instrumentit matës të ri ose të riparuar dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar. Ky instrument matës ligjërisht i kontrolluar certifikohet me shenjën e verifikimit fillestar. 3. Kur instrumenti matës i nënshtrohet verifikimit fillestar, kontrolli duhet të përcaktojë nëse: a) instrumenti i përket një kategorie të përjashtuar nga tipi i miratuar dhe, në këtë rast, nëse përmbush kërkesat teknike dhe funksionale; b) instrumenti matës është i tipit të miratuar dhe në përputhje me të.

Gjithashtu bien në kundërshtim dhe me nenin 25.2 të kushteve specifike të publikuara nga BE për kontratat e projekteve IPA në të cilën specifikisht theksohet :...."Kontraktori do të furnizojë, instalojë, dhe komisionojë të gjitha pajisjet, bashkuset, përshtatëset, përfshirë instalimin final dhe lidhjet e të gjitha pjesëve të ndryshme të pajisjes bashkuseve dhe përshtatësve në mënyrë që pajisjet të lihen në vend gati për përdorim të plotë. Kostot e pjesëve të përdorshme dhe konsumueshme gjatë instalimit dhe testimit para pranimit provizor do të përballohen nga kontraktori".

Të gjitha problematikat për aparaturat jashtë kushteve të specifikimeve teknike, të konstatimit të aparaturave të pakolaudura dhe të vazhdimin të tyre edhe aktualisht jashtë kushteve të përdorimit, i janë bërë me dije në mënyrë të vazhdueshme nga përgjegjësi i laboratorit (anëtar i grupit të marrjes në dorëzim) si Agjencisë Kombëtare të Ushqimit dhe SPO (menaxhimin të projektit znj. E. T) si dhe njoftim të gjithë stafeve drejtuese të MBUZHR dhe AKU. Kundërshtimi për axhustimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

dhe kalibrimin e tre pajisjeve nga stafi i AKU apo institucion tjetër përfitues dhe argumentimi i këtij fakti, është bërë dhe pas takimit ku pretendohet se është dakordësuar mes kontraktorit, ISUV (si laborator reference) dhe 3 DRAKU që axhustimi i pajisjeve të realizohet nga ISUV me mbështetjen e kontraktorit për disa produkte dhe parametra të dakordësuar mes palëve”.

Nga grupi i auditimit u bë verifikimi fizik i pajisjeve të Lotit 1 për sasinë dhe përputhjen me specifikimet teknike dhe ofertën, ku u konstatuan problematika trajtuar sa më sipër (bashkëlidhur Chek lista për Lotin 1 paraqitur në Aneksin 2)

Mbi pajisjet e marra në dorëzim paraprak (provizor) në DRAKU Korçë

Qëllimi fillestar i projektit ka qenë **“Lehtësimi dhe mbështetja e kapaciteteve të administratës kombëtare që të sigurohet një përmirësim mbi sigurinë e plotë të zinxhirit ushqimor”**.

Rezultatet e pritshme të projektit ishin; (1) Një rrjet laboratorik në përputhje me një kornizë ligjore të qartë dhe funksionale si edhe me kosto efektive; (2) Kapacitete analitike dhe diagnostikuese të sistemit laboratorik, përmes aplikimit të metodave e teknikave moderne.

Loti 1, Siguria Ushqimore.

Qëllimi i lotit 1 është **“forcimi i seksioneve të testimit fiziko-kimik në DRAKU Korçë, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve”**.

Drejtoria DRAKU Korçë ka përfituar 5 pajisje në këtë lot, nga 5 të planifikuara nga projekti IPA 2013 që janë pajisje të analizave të shpejta. Nga auditimi ka rezultuar

Konkluzion i grupit të auditimit:

*-Tre pajisjet; Near Infra Red Food multiparametric analyzer; Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser; dhe Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser, janë të pa kalibruara, për rrjedhojë të pa përdorshme për të dhënë një rezultat të saktë laboratorik. Pajisjet duhet të kalibrohen nga furnitori sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, ku specifikohet se **“Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar është përgjegjësi e furnitorit”** dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt ku specifikohet në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë, **“The inspection and testing prior to the provisional acceptance will take place at the locations where the equipment is delivered, installed and put into operation (Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë).”***

-Konkludojmë gjithashtu se tre pajisjet e tipit NIR (near infra red) janë në gjendje të analizojnë secila prej tyre një mostër brenda 45- 60 sekondave. Në këndvështrimin e efektivitetit të tyre referuar spektrit të gjerë të analizave që kryejnë për produkte dhe parametra referuar manualeve bashkëlidhur pajisjeve të dorëzuara, në DRAKU Korçë citojmë se pajisja “Near Infra Red Food multiparametric analyzer” me disa pjesë shtesë si sirtar dhe pompë lëngjesh, është në gjendje të kryej edhe analizat që mbulojnë dy pajisjet e tjera NIR. Referuar shpejtësisë së kryerjes së analizave pajisja “Near Infra Red Food multiparametric analyzer” zëvendëson në mënyrë efektive dy pajisjet e tjera: “Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser” dhe “Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser”.

-DRAKU Korçë nuk ka vënë në punë pajisjen “Milk and milk products multiparametric analyzer”. Pajisja është funksionale dhe mund të prodhojë analiza. Pajisja “Florescent microscopic Somatic Cell Counter” nuk është vënë në funksion për mungesë tarifash, pavarësisht se është në gjendje pune.

Pajisjet e Lotit 1 me përjashtim të pajisjes “Florescent microscopic Somatic Cell Counter” nuk prodhojnë analiza sipas standardeve kombëtare, ato janë pajisje të analizave të shpejta të parametrave të produkteve ushqimorë.

Loti 3, Shëndeti i Kafshëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Qëllimi i këtij loti ka qenë forcimi i seksioneve të testimit të shëndetit të kafshëve në DRAKU Korçë, përmes pajisjeve të përfshira në këtë lot.

Pajisje jo në përputhje me specifikimet e kërkuara: Nuk ka.

Konkluzion i grupit të auditimit;

-Nga pajisjet e **lotit 3**, shëndeti i kafshëve pajisja ARH_6 (Colony Counter manual use) shërben për numërim te kolonive te baktereve, duke përmbushur qëlliminë saj Kjo pajisje nuk është vënë në funksion.

-Pajisja ARH_4 (Microscope with high resolution at least 3 megapixel digital camera); ARH_9 (Microbiological incubator capacity 80l); janë pajisje që plotësojnë qëllimin e forcimit të testimit të shëndetit të kafshëve

-Pajisjet e më poshtme nuk janë vënë në funksion edhe pse ato nuk kanë asnjë nevojë për kalibrim apo tarifa, pasi janë pajisje ndihmëse.

-Pajisjet e tjera; ARH_1 (Analytical balance 1mg, capacity at least 410g); ARH_2 (Water bath ambient 5°C to 95°C capacity at least 8 litres); ARH_3 (Adjustable automatic pippets 100-1000µl); ARH_5 (Benchtop centrifuge); ARH_7 (Hot plate Magnetic stirrer); ARH_10 (Refrigerators/Freezers 0/-20°C with at least 295 litres overall capacity); ARH_12 (Digital reference thermometer termocouple PT 100) janë pajisje ndihmëse në analiza.

-Kurse pajisja ARH_11 (UPS station 6000 VA) është vetëm pajisje për mirëmbajtjen tensionit të stabilizuar në rrjetin elektrik, dhe nuk ka asnjë influencë në përmirësimin apo përkeqësimin e arritjes së objektivave në shëndetin e kafshëve, në kuadër të projektit IPA 2013.

Loti 4, Mbetjet e Pesticideve.

Qëllimi lotit 4 është testimi dhe verifikimi i mbetjeve pesticide në ushqime. Rolin kryesor për përmbushjen e qëllimit do ta kryej Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV). Pajisjet e përfituara në lotin 4 nga DRAKU Korçë janë:

-Pajisja PCT_1 (Duckless chemical fume hood at least 1500mm width)

-Pajisja PCT_2 (Aspirated and filtered safety cabinets for storage of chemicals, acids and bases, minimum external width 1190mm height 1900mm)

Konkluzion i grupit të auditimit;

Dy pajisjet e përfituara nga loti 4, nuk përmbushin ndonjë qëllim për përmirësimin e cilësisë laboratorike në AKU lidhur me mbetjet e pesticideve në DRAKU Korçë.

(Chek lista e loteve 1,3,4 bashkëlidhur paraqitur në Aneksin 2)

Regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit.

Nga auditimi në DRAKU Korçë rezultoi:

Pajisjet nuk janë bërë hyrje në DRAKU Korçë, për rrjedhojë nuk ka gjurmë regjistrimi në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të vitit 2018, pavarësisht se akti i marrjes në dorëzim provizor mban datën 12.11.2018 për Lotin 3 dhe 4 dhe 12.12.2018 për Lotin 1. Argumenti i dhënë nga financa e DRAKU Korçë (znj. Juliana Shytko me detyrë përgjegjëse e sektorit të shërbimeve që mbulon financën, njëkohësisht dhe anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim) ka qenë mungesa e faturës që shoqëronte mallin.

Nga financa e DRAKU Korçë është bërë njoftimi i Zyrës së Financës AKU në prill të 2019 (periudhë auditimi), që për pajisjet e ardhura pritet dokumentacioni për regjistrimin e tyre.

Aktualisht në Ministrinë e Financave më datën 17 Prill 2019 është mbajtur takim me përfaqësuesit e zyrave të financave të ministrive dhe institucioneve vartëse përfituese të fondeve IPA dhe për fondet IPA 2013 të përfituara nga AKU u la detyrë regjistrimi i menjëhershëm i përfitimeve në kontabilitetin e përfituesit. Në konkluzionet e takimit citohet: “Procesi i regjistrimit të aseteve duhet të përfundojë sa më shpejt pas marrjes provizore. Ju komunikua të gjithë pjesëmarrësve që në fund



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

të procesit, të gjithë përfituesit duhet të komunikojnë zyrtarisht CFCU për regjistrimin e aseteve me prova të mjaftueshme. Ju shpjegua përfituesve që të konsultoheshin midis tyre mbi mënyrën se si do të konkludojnë për regjistrimin e aseteve”.

Në takimin e organizuar ka qenë pjesëmarrëse znj.L. V me detyrë shefe e financës së AKU e cila ka përcjellë detyrimin e regjistrimit në kontabilitet tek DRAKU përfituese me datën 7 maj 2019. Kurse kërkesën për sigurimin e faturës së përfitimit për çdo DRAKU përfituese (Korçë, Shkodër, Gjirokastrë)si dokument drejtuar SPO e ka rezultuar me 2 maj 2019. Në momentin e auditimit nuk ka asnjë procedurë të mëtejshme për regjistrimin e aseteve.

Aktualisht mos regjistrimi në kohën e marrjes në dorëzim bie në kundërshtim me SKK5 (pasi pajisjet quhen të gatshme për përdorim). Gjithashtu mos regjistrimi kontabël bie në kundërshtim dhe me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60 në të cilat citohet:

“ Pika 56: Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivitetit i përcjell akt-konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pas ardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse.

Pika 57: Për hyrjet e aktiveve të dhuruara dokumentacioni shoqëruar përbëhet nga Marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësisë donatore; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (në rast importi); Procesverbali i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Në rastet kur dhurimet në natyrë të aktiveve nga donatorë të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre.

Pika 58: Bëhet kontrolli i artikujve sipas sasisë dhe çmimit (sasia dhe çmimi që ka fatura e furnitorit që bën dalje aktivitet duhet të jenë të njëjta me ato të regjistruara nga magazinieri në fletë-hyrje), kryhen shumëzimet dhe nxirret vlera totale e fletë-hyrjes.

Pika 59: Bëhet kontrolli i fletë-daljes së magazinës për daljet e brendshme me listë shpërndarjen, për çdo artikull në sasi dhe në vlerë të firmosur nga sektori i shërbimit përkatës.

Pika 60: Bëhet regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre. Në dokument shënohet numri i faqes së librit dhe si fraksion numri rendor që ka marrë regjistrimi i kryer. Në fund të çdo muaji dokumentet e regjistruar vendosen në dosjen përkatëse.

Nga struktura urdhëruese e marrjes në dorëzim duhet të ishte vënë në dispozicion dokumentacioni i duhur ashtu siç përcaktohet në kushtet specifike të publikuara nga BE për kontratat e projekteve IPA në artikulli 29 “Dorëzimi” ku theksohet specifikisht:

“Çdo ofertë duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:1. sigurim kontrate, 2. lista e paketimit, 3. faturë, 4. garanci certifikate (duke përfshirë procedurat e kërkesave), 5. certifikatën e origjinës (Certifikata e origjinës duhet të identifikojë qartë mallrat që i referohet).

Nga MBZHR dokumentacioni i marrjes në dorëzimi vënë në dispozicion të përfituesve ka qenë vetëm specifikimet teknike të loteve të kontraktuara dhe ato të ofertuesit për to.

(Mbajtur Akt konstatim nr.2)

Procesi i marrjes në dorëzim paraprak në DRAKU Shkodër

Për Lotin 3

Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim është mbajtur nga grupi i ngritur me urdhrin e ministrit nr.326,datë 30.07.2018 i përbërë nga :

1. Znj,Z. C Përgjegjës ne Sektorin e Shërbimeve Laboratorike, DRAKU Shkodër
2. Znj. A. K, Përgjegjëse ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Shkodër,
3. Z. A. Z, Specialist ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Shkodër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

4. Z. A. A, Specialist ne Sektorin e Veterinarisë dhe Mirëqenies se kafshëve, MBZHR nuk ka firmosur pasi është larguar nga detyra

5. Z. N. P, Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Programeve te Zhvillimit ne Fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, MBZHR,

me datën 15.11.2018, kanë konfirmuar për ardhjen e sasive të pajisjeve dhe pjesëve përbërëse të përcaktuara për DRAKU Shkodër të lotit 3 (pajisjet, pjesët e këmbimit, materialet e konsumueshme sipas parashikimit të kontratës). Gjithashtu në aktin e marrjes në dorëzim të përkohshëm nga grupi i marrjes në dorëzim citohet se:

“Gjatë verifikimit u identifikua se te gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori.... Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Pajisjet janë shoqëruar me manualët përkatëse dhe pjesët e këmbimit duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në kontratë.”

Grupi i auditimit verifikoi listën e pajisjeve të pritura(ardhura) dhe pjesëve të tyre, me ekzistencën fizike të tyre në ambientet e instaluar, nga ku rezultoi se nuk u paraqitën deviacione (chek lista loti 3 bashkëlidhur paraqitur në Aneksin 3)

Për Lotin 4

Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim është mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim:

1. Znj,Z. C Përgjegjës ne Sektorin e Shërbimeve Laboratorike, DRAKU Shkodër

2. Znj. A. K, Përgjegjëse ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Shkodër,

3. Z. A. Z, Specialist ne Sektorin e Shërbimeve te Brendshme, DRAKU Shkodër

4. Z. A. A, Specialist ne Sektorin e Veterinarisë dhe Mirëqenies se kafshëve, MBZHR nuk ka firmosur pasi është larguar nga detyra

5. Z. N. P, Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Programeve te Zhvillimit ne Fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, MBZHR,

të cilët me datën 15.11.2018, kanë konfirmuar për ardhjen e sasive të mallrave të përcaktuara për DRAKU Shkodër në lotin 4 (pajisjet,pjesët e këmbimit, materialet e konsumueshme sipas parashikimit të kontratës). Gjithashtu në aktin e marrjes në dorëzim të përkohshëm nga grupi i marrjes në dorëzim citohet se:

“Gjate verifikimit u identifikua se të gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori.... Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Pajisjet janë shoqëruar me manualët përkatëse dhe pjesët e këmbimit duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në kontratë.”

Grupi i auditimit verifikoi listën e pajisjeve të pritura(ardhura) dhe pjesëve të tyre, me ekzistencën fizike të tyre në ambientet e instaluar, nga ku rezultoi se nuk u paraqitën deviacione (chek lista loti 4 bashkëlidhur paraqitur në Aneksin 3).

Për Lotin 1

Procesverbali është mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim. Në këtë procesverbal nuk ka datë të përcaktuar të marrjes në dorëzim. Grupi i marrjes së përkohshme në dorëzim

1. Znj,Z. C

2. Znj. A. K, 3. Z. A. Z, 4. Z. N. P, Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Programeve te Zhvillimit ne Fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, MBZHR, kanë cituar në procesverbal:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

“Gjate verifikimit u identifikua se te gjitha pajisjet e dorëzuara ishin në përputhje me Specifikimet Teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratë. Gjithashtu të gjitha pajisjet përputhen me modelin e ofruar në ofertën teknike (përfshirë dhe Urdhrin Administrativ për pajisjen nr.1) dhe katalogët mbështetës (pjesë e kontratës). Të gjitha pajisjet janë instaluar, testuar nga Kontraktori si dhe shumica e tyre janë vënë në përdorim të përditshëm. Pajisjet gjatë përdorimit nuk kanë shfaqur problematika në funksionim. Për pajisjet nr.2, nr.3 dhe dhe nr.5 gjatë trajnimit të zhvilluar u evidentuan pasaktësi në matje, të cilat lidhen me nevojën e axhustimit të tyre (sqaruar në shënimin më poshtë). Pajisjet janë shoqëruar me pjesët e këmbimit dhe materialet e konsumueshme”.

Në shënimin citohet:

“ Në lidhje me pajisjet NIR (2,3,5) me qëllim nxjerrjen e saktësisë së rezultateve nevojitet axhustimi i tyre në përputhje me metodat e referencës. Aktualisht sipas kërkesës së specifikimeve teknike dhe kontratës, kjo nevojë nuk është parashikuar për tu zhvilluar nga Kontraktori. Me qëllim funksionimin sa më të mirë të pajisjes u dakordësua në takime të përbashkëta mes kontraktorit, ISUV (si laborator reference) dhe 3 DRAKU që axhustimi i pajisjeve të realizohet nga ISUV me mbështetjen e kontraktorit për disa produkte dhe parametra të dakordësuar mes palëve”.

Sa mësipër cituar në shënimin e procesverbalit, grupi i marrjes në dorëzim ka dalë jashtë kontekstit të detyrimit të përcaktuar në urdhrin e ministrit nr.327,datë 30.07.2018, ku në pikën 3 citohet: “Grupi i punës do të kryejë verifikimin e pajisjeve të dorëzuara nga kontraktori në përputhje me Specifikimeve teknike, ofertën teknike dhe materialet mbështetëse të cilat janë pjesë e kontratës. Gjithashtu ai do të verifikojë përmbushjen e rregullit të origjinës të pajisjeve të dorëzuara”.

Nga shpjegimet e bëra ka rezultuar SPO ka qenë prezent në momentin e konfirmimit të aktit i cili ka qenë dokument i parapërgatitur dhe si rrjedhojë e rënies dakord midis palëve në takimet paraprake në ministri (SPO Kontraktor ISUV dhe AKU, DRAKU). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (kryesisht imelet zyrtare të përgjegjëses së laboratorit dhe anëtare e marrjes në dorëzim të DRAKU Shkodër), komentohet se disa pajisje të lotit 1 nuk janë të gatshme për punë dhe ato nuk mund të kalibrohen konform metodikave nga laboratorët e DRAKU pasi kanë kosto, duan kohë dhe mostrat duhen të jenë prezent dhe mostra reference. Edhe DRAKU Shkodër është i dakordësuar me problematikat e ngritura nga DRAKU Korçë nëpërmjet përgjegjësit të laboratorit z. Dh.P. të datës 5 nëntor 2018(mbas takimit të organizuar mes palëve në ministri). Nga DRAKU Shkodër referuar kërkesës së SPO znj. E, T. është vendosur bashkëlidhur lista me pajisjet që çfarë analizojnë për produkt dhe çfarë kërkohet shtesë për tu axhustuar nga kontraktori P. dhe ISUV, duke kushtëzuar kështu numrin e produkteve dhe të analizave për produkt (kjo vetëm referuar nevojave aktuale) pa marrë në konsideratë që ky është një financim për funksionimin në vijim të laboratorëve.

Aktualisht grupi i auditimit referuar gjithë korespondencës së vënë në dispozicion si dhe krahasimit të specifikimeve teknike të tenderit dhe atyre të ofruara krahasuar me gjendjen aktuale të tre pajisjeve, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

1. Pajisjet vazhdojnë dhe në momentin aktual të jenë jashtë funksioneve të tyre dhe nuk përdoren për faktin e mos nxjerrjes së analizave korrekte.

Për këtë sqarojmë se në DRAKU Shkodër pajisjet kanë ardhur fillimisht në 27 Qershor 2018 . Mbas verifikimit nga grupi i marrjes në dorëzim me dokumentacionin specifikime teknike të tenderit dhe ofertës së paraqitur nga Kontraktori Pegasus dhe Evita rezultoi se pajisjet e Lotit 1 si: 1. Spectra Alyzer, 1.Grain, 2.Food, 3.Vine & Spiritues ishin në mungesë totale të parakalibrimeve. Aktualisht tre pajisjet nuk janë gati për tu përdorur as në momentin aktual.

Në ofertën e paraqitur nga Kontraktori Evita për këto pajisje theksohet se të gjitha kalibrimet për të gjitha parametrat janë përfshirë në aparatura. (dokumenti i lotit 1. Aparatura 2,3,5) Aktualisht nga testimet e kryera ka rezultuar se kalibrimet dhe parametrat e përfshira në to janë shumë më pak se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

sa kërkohet në dokumentet e tenderit duke theksuar veçanërisht Spectra Alyzer Grain, Spectra Analyzer Food të cilat janë në kundërshtim me specifikimet e tenderit.

Rënia dakord e SPO (në takimin midis palëve kontraktues, menaxhues projekti, përfitues, ekspert projekti) në lidhje me axhustimin dhe kalibrimin e parametrave nga ISUV në bashkëpunim me kontraktin, është një zgjidhje jo ligjore, jo në përputhje me të gjitha kërkesat e specifikimeve të tenderit, ku për pajisjet kërkohen analizimi i shumë produkteve dhe shumë parametrave për secilin produkt me qëllim bërjen e analizave produktive, dhe efektive në drejtim të sigurisë ushqimore (pra rritur gamën e analizimit jo vetëm në drejtim të shpejtësisë po dhe cilësisë) ku ky ishte dhe qëllimi i financimit të projektit dhe jo qëndrim në të njëjtin stad aktual. Gjithashtu detyrimi i furnizimit të pajisjeve të gatshme për punë, pra kryerjen e analizave të sakta gjatë testimit të vënies në punë nga kontraktori, referuar akteve ligjore në fuqi është i kontraktorit (furnizuesit). Veprimet sa më sipër bien në kundërshtim me ligjin nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar, neni 25 Gjithashtu bien në kundërshtim dhe me nenin 25.2 të kushteve specifike të publikuara nga BE për kontratat e projekteve IPA (dhe dosjen e tenderit për IPA 2013 të datës 19.08 2019) në të cilën specifikisht theksohet :....”Kontraktori do të furnizojë, instalojë, dhe komisionojë të gjitha pajisjet, bashkuset, përshtatëset, përfshirë instalimin final dhe lidhjet e të gjitha pjesëve të ndryshme të pajisjes bashkuese dhe përshtatësve në mënyrë që pajisjet të lihen në vend gati për përdorim të plotë. Kostot e pjesëve të përdorshme dhe konsumueshme gjatë instalimit dhe testimit para pranimit provizor do të përballohen nga kontraktori”.

Nga grupi i auditimit u bë verifikimi fizik i pajisjeve të Lotit 1 për sasinë dhe përputhjen me specifikimet teknike dhe ofertën, ku u konstatuan problematika trajtuar sa më sipër (bashkëlidhur Chek lista për Lotin 1,3,4 paraqitur në Aneksin 3)

Mbi pajisjet e marra në dorëzim në DRAKU Shkodër

Loti 1, Siguria Ushqimore.

Qëllimi i lotit 1 është **“forcimi i seksioneve të testimit fiziko-kimik në DRAKU Shkodër, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve”**.

Drejtoria DRAKU Shkodër ka përfituar 5 pajisje në këtë lot, nga 5 të planifikuara nga projekti IPA 2013 që janë pajisje të analizave të shpejta.

Konkluzion i grupit të auditimit;

*-Tre pajisjet; Near Infra Red Food multiparametric analyzer; Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser; dhe Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser, janë të pakalibruara, dhe jo me të gjitha parametrat e kërkuara në specifikimet teknike, për rrjedhojë janë të pa përdorshme për të dhënë një rezultat të saktë laboratorik. Pajisjet duhet të kalibrohen nga furnitori sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, ku specifikohet se **“Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar është përgjegjësi e furnitorit”** dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt ku specifikohet në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë, “The inspection and testing prior to the provisional acceptance will take place at the locations where the equipment is delivered, installed and put into operation **(Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku paisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë).**”*

-Në këndvështrimin e efektivitetit të tyre referuar spektrit të gjerë të analizave që kryejnë brenda një kohe shumë të shkurtër, për produkte dhe parametra referuar manualeve bashkëlidhur pajisjeve të dorëzuara, në DRAKU Shkodër citojmë se pajisja “Near Infra Red Food multiparametric analyzer” me disa pjesë shtesë si sirtar dhe pompë lëngjesh, është në gjendje të kryej edhe analizat që mbulojnë dy pajisjet e tjera NIR. Referuar shpejtësisë së kryerjes së analizave pajisja “Near



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Infra Red Food multiparametric analyzer” zëvendëson në mënyrë efektive dy pajisjet e tjera: “Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser” dhe “Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser”.

-DRAKU Shkodër nuk ka vënë në punë pajisjen “Milk and milk products multiparametric analyzer” dhe pajisjen “Florescent microscopic Somatic Cell Counter” për mungesë tarifash, pavarësisht se janë në gjendje pune.

-Pajisjet që janë dorëzuar në DRAKU Shkodër, “Near Infra Red Food multiparametric analyzer”, “Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser”, “Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser”, dhe “Milk and milk products multiparametric analyzer” janë pajisje të testeve të shpejta. Këto pajisje, nuk realizojnë analizim sipas standardeve kombëtare.

Pajisja analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët, shërben për matjen e; (1)proteinave, (2) yndyrave, (3) densitetin, (4) laktozën, (5) kripshmërinë, (6) SNF (të ngurta jo yndyrore), (7) ujë i shtuar.

Kontraktori në ofertën e vet ka ofruar që pajisja kryen edhe matjen e (8) pH, dhe (9) përcjellshmërinë elektike. Pajisja aktualisht nuk i kryen të gjitha analizat e specifikuar. Në printimin e spektrit të analizave, që kjo pajisje nxjerr, nuk shfaqet si vlerë pH dhe përcjellshmëria elektrike. Në të nuk kishte të montuar pH-metrin, shtesë që duhet të vinte bashkë me pajisjen referuar manualit të ofruar nga ofertuesi fitues.

Loti 3, Shëndeti i Kafshëve.

Qëllimi i këtij loti ka qenë forcimi i seksioneve të testimit të shëndetit të kafshëve në DRAKU Shkodër, përmes pajisjeve të përfshira në këtë lot.

Pajisje jo në përputhje me specifikimet e kërkuara: Nuk ka.

Konkluzion i grupit të auditimit;

Pajisjet e më poshtme nuk janë vënë në funksion edhe pse ato nuk kanë asnjë nevojë për kalibrim apo tarifa, pasi janë pajisje ndihmëse.

-Pajisja ARH_6 (Colony Counter manual use) duke përmbushur qëllimin e këtij loti.

-Pajisja ARH_4 (Microscope with high resolution at least 3 megapixel digital camera);

janë pajisje që plotësojnë qëllimin e forcimit të testimit të shëndetit të kafshëve

-Pajisjet e tjera; ARH_1 (Analytical balance 1mg, capacity at least 410g); ARH_2 (Water bath ambient 5°C to 95°C capacity at least 8 litres); ARH_3 (Adjustable automatic pippets 100-1000µl); ARH_5 (Benchtop centrifuge); ARH_7 (Hot plate Magnetic stirrer); ARH_8 (Vortex Mixer); ARH_10 (Refrigerators/Freezers 0/-20°C with at least 295 litres overall capacity); ARH_12 (Digital reference thermometer thermocouple PT 100) janë pajisje ndihmëse në analiza.

-Kurse pajisja ARH_11 (UPS station 6000 VA) është vetëm pajisje për mirëmbajtjen tensionit të stabilizuar në rrjetin elektrik, dhe nuk ka asnjë influencë në përmirësimin apo përkeqësimin e arritjes së objektivave në shëndetin e kafshëve, në kuadër të projektit IPA 2013.

Loti 4, Mbetjet e Pesticideve.

Qëllimi lotit 4 është testimi dhe verifikimi i mbetjeve pesticide në ushqime. Rolin kryesor për përmbushjen e qëllimit do ta kryej Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV). Pajisjet e përfituara në lotin 4 nga DRAKU Shkodër janë:

-Pajisja PCT_1 (Duckless chemical fume hood at least 1500mm width)

-Pajisja PCT_2 (Aspirated and filtered safety cabinets for storage of chemicals, acids and bases, minimum external width 1190mm height 1900mm)

Konkluzion i grupit të auditimit;

Dy pajisjet e përfituara nga loti 4, nuk përmbushin ndonjë qëllim për përmirësimin e cilësisë laboratorike në AKU lidhur me mbetjet e pesticideve në DRAKU Shkodër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Mbi regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe legjislacionin në fuqi në DRAKU Shkodër

Pajisjet nuk janë bërë hyrje në DRAKU Shkodër, për rrjedhojë nuk ka gjurmë regjistrimi në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të vitit 2018, pavarësisht se akti i marrjes në dorëzim provizor mban datën 15.11.2018 për Lotin 3 dhe 4 dhe në dhjetor 2018 për Lotin 1. Argumenti i dhënë nga financa e DRAKU Shkodër (znj. Ardita Kallamishti me detyrë përgjegjëse e sektorit të shërbimeve që mbulon financën, njëkohësisht dhe anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim) ka qenë mungesa e faturës që shoqëronte mallin.

Nga financa e DRAKU Shkodër nuk ka njoftim për këtë fakt tek titullari i DRAKU Shkodër dhe në AKU.

Aktualisht mos regjistrimi në kohën e marrjes në dorëzim bie në kundërshtim me SKK5 (pasi pajisjet quhen të gatshme për përdorim). Gjithashtu mos regjistrimi kontabël bie në kundërshtim dhe me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60.

(Mbajtur Akt konstatim nr.3)

Mbi pajisjet e marra në dorëzim paraprak(provizor) në DRAKU Gjirokastrë

Grupi i Auditimit u paraqit në DRAKU Gjirokastrë për të kryer auditimin sipas dokumentacionit që duhej të vihej në dispozicion dhe procedurës audituese, konform rregullave dhe procedurave të miratuara në manualin e auditimit të përputhshmërisë dhe rregulloren e brendshme të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga ky auditim rezultoi:

Grupi i auditimit realizoi takimin me Drejtorin e DRAKU Gjirokastrë z. B.B. me datën 13.05.2019 ku parashtrroi procedurën e auditimit që do të kryhej si dhe sektorët me të cilët duhet të bashkëpunonte për të realizuar drejtimete auditimit.

Nga ana e Drejtorit të DRAKU Gjirokastrë u prezantua fakti që Drejtori i Përgjithshëm AKU z. A. H. i kishte vënë në dispozicion shkresën, që ky i fundit me datën 10.05.2019 i drejtohej Titullarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku kërkohej ndërprerja e auditimit, si një auditim jashtë kompetencave të KLSH. *Në momentin aktual, pra me datën 13.05.2019, theksojmë se nuk kishte një përgjigje zyrtare nga dy institucionet.*

Grupi i auditimit dha shpjegimet se përveç kundërshtisë ligjore për këtë shkresë, e cila do të jepet e argumentuar ligjërisht dhe zyrtarisht nga KLSH, por paraqiti dhe faktet se Drejtori i Përgjithshëm i AKU e ka pranuar auditimin, referuar faktit të shkresës së njoftimit për këtë auditim me nr.216, datë 25.03.2019 dhe ka pranuar programin e auditimit me nr. 216/1 datë 8.04.2019 të protokolluar në AKU me datën 15.04.2019 me protokoll nr.2281. Referuar këtij programi grupi i auditimit ka vazhduar të kryejë procesin e auditimit deri me datën 10.05.2017.

Nga drejtori i DRAKU Gjirokastrë u dha argumenti që nuk mund të lejonte vazhdimin normalisht të auditimit në DRAKU Gjirokastrë referuar shkresës së cituar dhe urdhrin verbal të titullarit të AKU për të mos lejuar auditimin.

Sa mësipër nga grupi i auditimit u mbajt akt konstatim nr.1 për të vërtetuar faktin e moskryerjes së auditimit të programuar dhe të njoftuar më parë në AKU dhe për të cilin kishin dijeni dhe më parë të tre DRAKU (Korça, Shkodra dhe Gjirokastra).

Veprimet sa mësipër bien në kundërshtim me ligjin nr.154,datë 2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH" nenin 9, nenin 12, nenin 26 i Kreut IV"e drejta e disponimit dhe informacionit" pika 1,2,

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Gjirokastrë (në vijim DRAKU Gjirokastrë) ka qenë përfutuese e 5 pajisjeve në lotin 1, 8 pajisje në lotin 3, 2 pajisje në lotin 4.

Grupi i auditimit nuk verifikoi këto pajisje, por të dhënat e paraqitura i referohen aktit të marrjes provizore në dorëzim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Mbi pajisjet e marra në dorëzim funksionet e tyre dhe rëndësinë që zënë në procesin e analizimit të ushqimeve dhe produkteve ushqimore ka trajtim më të zgjeruar në Projekt Raportin e Auditimit.

Gjithashtu me poshtë po pasqyrojmë sqarimet e observacioneve të z.N. P. punonjës i MBZHR, përfaqësues i ministrisë në komisionet e marrjes në dorëzim në DRAKU Korçë, Shkodër e Gjirokastrë.

- “Për aktverifikimet nr.2 dhe nr.3 nga z.N. P. është bërë observacion ku pretendohet se në cilësinë e anëtarit të komisionit të verifikimit dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve laboratorike për ISUV dhe 3 drejtoritë rajonale të AKU, duke përfaqësuar MBZHR në këtë proces, nuk jam njoftuar, kontaktuar apo intervistuar gjatë procesit të auditimit në të njëjtat kushte me anëtarët e tjerë të këtyre dy grupeve”.

Sa mësipër sqarojmë se grupi i auditimit ka bërë auditim në DRAKU Korçë dhe Shkodër dhe konstatimet e shkruajtura në akt kanë rezultuar gjatë auditimit në këto DRAKU. Auditimi nuk ishte i pa lajmëruar por i lajmëruar paraprakisht dhe me përcaktim të drejtimit të auditimit, kështu që ky detyrim ishte i AKU. Ne audituam procesin në vendin përkatës. Për konkluzionet ndjem detyrimin për tju njoftuar me imail me qenëse aktet tona nuk u pranuan të protokolloheshin sipas urdhërit të Drejtorit të AKU z. H., ku detyrim i institucionit të tij ishte njoftimi për ju (këtë e vërteton dhe dokumenti Akt konstatim i hartuar sipas dokumenteve standard të KLSH, faqja e fundit).

Gjithashtu pretendohet se: “Gjatë procesit jam informuar në lidhje me çështjet e ngritura nga Përgjegjësi i Laboratorit të Drejtorisë rajonale Korçë, në lidhje me saktësinë në matje për 3 pajisje NIR, e shfaqur gjatë trajnimit të stafit të laboratorëve nga Kontraktori (në të cilin nuk kam qenë pjesëmarrës). Ky pretendim i ngritur nga Z. Dh. P., përgjegjës i laboratorit të AKU Korçë, është marrë në shqyrtim nga përfaqësuesit e MBZHR, duke organizuar disa takime/ diskutimeve me të gjithë palët e përfshira në proces (CFCU, kontraktorin, 3 drejtoritë rajonale të AKU, ISUV, ekspertë të fushës, ekspertë të kontratës së shërbimit të financuar nga BE). Në dispozicion gjeni minutat e takimeve të vëna në dispozicion nga njësia përkatëse në MBZHR (materiali nr. 3 dhe 4). Kjo kontratë menaxhohet dhe zbatohet sipas klauzolave të përcaktuara në kontratën në fjalë dhe specifikimeve teknike të kërkuara për secilën pajisje”.

Sqarojmë se procesi i marrjes në dorëzim në bazë të ligjit në fuqi, është detyrë e komisionit të marrjes në dorëzim jo i CFCU dhe jo i SPO jo i ekspertit (ekspertit mund të kontraktohej dhe të bëheshe pjesë e grupit të marrjes në dorëzim). Pra ky komision duhet të kishte bindjen për përputhshmërinë e pajisjeve me specifikimet teknike dhe kompetencën për të kryer procesin e marrjes në dorëzim. Gjithashtu këtë akt nuk e ka firmosur asnjë ekspert i kontraktuar me përjashtim të grupit të marrjes në dorëzim.

Citojmë gjithashtu se në minutat e takimit dok.4 znj. K.ka cituar: “Sa i takon opsionit tjetër, që pranimi provizor të bëhet me një shënim në të cilin furnitori shprehet se do të angazhohet për të suportuar stafin teknik të laboratorëve gjatë procesit të axhustimit, Znj.K. u shpreh se një marrëveshje midis furnitorit dhe përfituesit mund të jetë e vlefshme për të dy palët, por jo për Autoritetin Kontraktor, sepse nuk është një dokument detyrues. Asnjë marrëveshje nuk mund të dalë jashtë kontratës”.

Dhe së fundmi theksojmë se nga auditimi në vend i kryer nga grupi i auditimit rezultoi se pajisjet vazhdonin të mos ishin në punë për efekt të mungesës së “ axhustimit” nga kontraktori detyrim ligjor i tij i cituar në kontratën dhe ligjin për metrologjinë cituar nga grupi gjatë konstatimit dhe trajtimit të shkeljes.

Në lidhje me materialin e vënë në dispozicion për opinionin e ekspertit (dokumenti 6) citojmë:

a- Ky raport nuk tregon se në prezencë të kujt është bërë ky vlerësim dhe të kishte konfirmimin e palëve (pra është opinion i tij)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

b- nuk është shoqëruar me kryerjen e disa provave analizuuese me pajisjet dhe këto analiza të vendoseshin bashkëlidhur materialit raport.

c-eksperti pranon që pajisjet nuk janë në nivelin e prodhimit të analizave të sakta pasi pajisjet kanë nevojë për axhustime.

d. raporti i ekspertit mban datën 14 dhjetor 2018 në një kohë që procesverbali i marrjes në dorëzim mban datën 12.12.2018.

Sa më sipër trajtuam konkludojmë se nuk mund të merret në konsideratë observacioni i paraqitur nga ju duke e përforcuar me faktin se që të bësh axhustim duhet të jesh në radhë të parë laborator reference me kompetenca ligjore për ta bërë këtë gjë, ku AKU nuk është. Duhet të kesh mostra reference që AKU nuk ka (mostrat e referencës për të gjitha produktet dhe parametrat që do të analizohen kërkojnë angazhime të konsiderueshme financiare dhe stafe të akredituar për këtë gjë si dhe shumë kohë në dispozicion).Këtu theksojmë faktin që kanë kaluar pothuajse 1 vit nga mbërritja e pajisjeve dhe nuk ka asnjë veprim në drejtim të axhustimit apo të bërjes gati për kryerjen e analizave.

Ky sqarim për rëndësinë që ka mbetet në fuqi, edhe për raportin përfundimtar të auditimit, pasi nga ministria nuk është paraqitur observacion për Projekt Raportin e auditimit të AKU, ku ky i fundit(AKU) kishte detyrimin sipas ligjit (cituar në shkresën përcjellëse të Projekt Raportit) për dërgimin e tij të gjithë personave që përmendet në Projekt Raport.

1. Titulli i gjetjes: Marrja në dorëzim e pajisjeve të përfituara nga Loti 1

Situata:Nga auditimi në DRAKU Korçëkanë rezultuar 3 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:

1-Pajisja MPA_2 (Near Infra Red Food multiparametric analyzer) shërben për matjen e parametrave në produktet ushqimore në; mish, grurë, fara vajore, miell, ushqime të paketuara, niseshte, sheqer, produkte brumi etj. Kjo pajisje duhet të masë disa parametra njëherazi si; lagështirë, proteinë, yndyra, hiri, amidonin, sheqerna, aciditeti, kripshmërinë, në një gjatësi valore 900-2400 nm. Aktualisht pajisja e paraqitur mat 1-3 parametra të disa produkteve dhe jo të gjitha, aq më tepër ato që konsiderohen analiza të domosdoshme për produktin që analizohet. Pra kjopajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Pajisja është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme dhe një pjesë analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”

2-Pajisja MPA_3 (Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser) shërben për matjen e produkteve; (1)fara vajore, (2) miell, (3) grurë, (4) drithëra në një spektër drite 570-1100 nm, për parametrat kryesor; (1) proteinat, (2) lagështirën, (3) vajin, (4) fortësinë e kokrrave të drithërave, (5) përthithjen e ujit, (6) pesha hektrolitrale. Aktualisht pajisja e paraqitur mat 3 produkteve për vetëm 4 parametra dhe jo për të gjithë parametrat e kërkuar.

Pra kjopajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Pajisja gjithashtu është e pa kalibruar (nga testimi nxjerr rezultate analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

3-Pajisja MPA_5 (*Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser*) shërben për matjen e parametrave të verës dhe produkteve të tjera alkoolike, në një fluks rrezesh infra të kuqe me frekuencë 1400-2400 nm. *Kjopajisje është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar analiza të sakta.* Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “*must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).*”

Nga auditimi në DRAKU Shkodërkanë rezultuar 4 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:

-Tre pajisjet; Near Infra Red Food multiparametric analyzer; Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser; dhe Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser, janë të pakalibruara, dhe jo me të gjitha parametrat e kërkuara në specifikimet teknike, për rrjedhojë janë të pa përdorshme për të dhënë një rezultat të saktë laboratorik. Pajisjet duhet të kalibrohen nga furnitori sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt, në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë.

Gjithashtu pajisja analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët, shërben për matjen e; (1)proteinave, (2) yndyrave, (3) densitetin, (4) laktozën, (5) kripshmërinë, (6) SNF (të ngurta jo yndyrore), (7) ujë i shtuar.

Kontraktori në ofertën e vet ka ofruar që pajisja kryen edhe matjen e (8) pH, dhe (9) përcjellshmërinë elektike. Pajisja aktualisht nuk i kryen të gjitha analizat e specifikuar. Në printimin e spektrit të analizave, që kjo pajisje nxjerr, nuk shfaqet si vlerë pH dhe përcjellshmëria elektrike. Në të nuk kishte të montuar pH-metrin, shtesë që duhet të vinte bashkë me pajisjen referuar manualit të ofruar nga ofertuesi fitues.

Gjithashtu sa mësipër parashtruar për pajisjet citojmë se Kontrata “*Furnizim për laboratorët ushqimorë në Drejtorinë rajonale ISFV dhe NFA*” me 3 lote në total 1,937,593 Euro, nga të cilat IPA në vlerë 1,608,202 Euro dhe Buxheti i Shtetit në vlerë 329,390 Euro, me kontraktorë *Evita Ltd* për Lot 1 me vlerë 457,973 Euro pa TVSH, nga të cilat IPA 380,117 Euro dhe Buxheti i Shtetit 77,855 Euro, është lidhur nga CFCU dhe pagesat janë kryer prej saj duke dhënë miratimin për kryerjen e pagesës, dhe duke u mjaftuar me dorëzimin e pajisjeve dhe specifikimeve teknike të kontratës, në një moment ku nuk mund të arriheshin rezultate të pritshme nga kalibrimet e kryera, nuk mund të siguroheshe funksionaliteti i pajisjeve për dhënien e analizave të sakta.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion e njëjta situatë si dhe në DRAKU Shkodër paraqitet dhe në DRAKU Gjirokastër

Kriteri: Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt, në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë.

Ndikimi/Efekti: Pajisje të pa kalibruara që sprodojnë analiza të sakta.

Shkaku: pajisje jo në përputhje me specifikimet teknike dhe pa parakalibrime

Rëndësia: i lartë

1.1. Rekomandimi: - *Nga DRAKU Korçë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2MPA_3MPA_5), deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

1.2. Rekomandimi: -Nga DRAKU Shkodër të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2MPA_3MPA_5) , deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.

-Nga DRAKU Shkodër ti kërkohet furnitorit pajisja e pH-metrit shtesë për pajisjen analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët konform ofertës së paraqitur, si kusht për marrjen përfundimtare në dorëzim të saj.

1.3. Rekomandimi:Nga DRAKU Gjirokastrë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2 MPA_3 MPA_5) , deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.

-Nga DRAKU Gjirokastrë ti kërkohet furnitorit pajisja e pH-metrit shtesë për pajisjen analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët konform ofertës së paraqitur, si kusht për marrjen përfundimtare në dorëzim të saj.

1.4.Rekomandimi: Nga SPO në MBZHRreferuar faktit të angazhimit të saj në procesin e marrjes provizore në dorëzim në bashkëpunim me furnitorin të hartohet një plan afatshkurtër i detajuar me afate kohore e përgjegjësi për kalibrimin apo axhustimin e tre pajisjeve për të gjithë laboratorët përfutues pa kosto shtesë nga përfutuesit. Koha e përfitimit të jetë mundësisht brenda periudhës së garancisë së kontratës.

1.5.Rekomandimi: Nga CFCU të bëhet bllokimi i garancisë së kontratës prej 10% të parashikuar në pikën 12 të njoftimit të kontratës së furnizimit për kontraktin E. Ltd për Lot 1 deri në momentin e përfundimit të procesit të axhustimit apo kolaudit të pajisjeve (sipas planit të axhustimit të miratuar nga palët). Nga CFCU në marrëdhëniet me kontraktin të zbatohen të gjitha sanksionet e parashikuara në kontratë,(ku në rast mos përcaktimi në kontratë, sanksionet të vendosen në zbatim të akteve ligjore shqiptare apo të huaja mbi bazën e të cilave funksionon kontrata) për tejkalim të afateve të dorëzimit të pajisjeve të gatshme për përdorim.

1.6.Rekomandimi: Nga CFCUnë rastin e dështimit të procesit të kolaudit të pajisjeve nga furnitori të nis procedurat ligjore për arkëtimin e shumave të vlerës së pajisjeve të pa kolauduara dhe dëmin ekonomik të shkaktuar.

2.Titulli i gjetjes: Mbi regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit.

Situata:Nga auditimi në DRAKU Korçë e Shkodër rezultoi se pajisjet e furnizuara dhe të përfutura referuar Lotit 1, Lotit 3, Lotit 4 nuk janë bërë hyrje, për rrjedhojë nuk ka gjurmë regjistrimi në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të vitit 2018, pavarësisht se akti i marrjes në dorëzim provizor mban datën 15.11.2018 për Lotin 3 dhe 4 dhe në dhjetor 2018 për Lotin 1. Argumenti i dhënë nga zyrat e financës së DRAKU Korçë e DRAKU Shkodër ka qenë mungesa e faturës që shoqëronte mallin.

Aktualisht mos regjistrimi në kohën e marrjes në dorëzim bie në kundërshtim me SKK5 (pasi pajisjet quhen të gatshme për përdorim). Gjithashtu mos regjistrimi kontabël bie në kundërshtim dhe me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60.

Nga struktura urdhëruese e marrjes në dorëzim SPO e MBZHR nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni i duhur ashtu siç përcaktohet në kushtet specifike të publikuara nga BE për kontratat e projekteve IPA në artikulli 29 “Dorëzimi” ku theksohet specifikisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

“Çdo ofertë duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme: 1. sigurim kontrate, 2. lista e paketimit, 3. faturë, 4. garanci certifikate (duke përfshirë procedurat e kërkesave), 5. certifikatën e origjinës (Certifikata e origjinës duhet të identifikojë qartë mallrat që i referohet).

Nga MBZHR dokumentacioni i marrjes në dorëzimi vënë në dispozicion të përfituesve ka qenë vetëm specifikimet teknike të loteve të kontraktuara dhe ato të ofertuesit për to kjo e specifikuar dhe në urdhrat e titullarit për ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AKU e njëjta situatë paraqitet dhe në DRAKU Gjirokastër, pavarësisht se grupi i auditimit nuk u la të kryej verifikimet përkatëse, referuar urdhrat të pa argumentuar të titullarit të AKU.

Kriteri: SKK 5 dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60.

Ndikimi: Pajisjet nuk janë të paraqitura në regjistrin e aseteve dhe për rrjedhojë s’janë të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2018.

Shkaku: Mungesa e dokumentacionit shoqërues si faturë, garanci, certifikata e origjinës së prodhuesit.

Rëndësia: i lartë

2.1. Rekomandimi: *Nga SPO në komunikim me CFCU të përgatitet dokumentacioni konform artikullit 29” dorëzimi” i kontratave të projekteve IPA dhe ky dokumentacion ti vihet në dispozicion Institucioneve përfituese.*

2.2 Rekomandim: *Nga DRAKU Korçë, DRAKU Shkodër dhe DRAKU Gjirokastër, në bazë të dokumentacionit që duhet të vihet në dispozicion, të kryhet regjistrimi i aseteve (pajisje) dhe kontabilizimi në llogaritë përkatëse konform standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe akteve ligjore në fuqi.*

3. Titulli i gjetjes: Marrja në dorëzim e pajisjeve të përfituara nga Loti 1

Situata: Nga auditimi është konstatuar se në DRAKU Gjirokastër paraqitet e njëjta situatë si dhe në DRAKU Korçë dhe Shkodër, kjo referuar akteve të marrjes në dorëzim të vëna në dispozicion nga AKU, por grupi i auditimit nuk arriti të bëjë auditimin të pajisjeve të secilit Lot për përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike, gatishmërinë në punë, regjistrimet kontabile si dhe përdorimin e tyre në vijimësi, mbas marrjes në dorëzim të përkohshëm për arsyen e pengimit të këtij procesi nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU, duke e argumentuar si një auditim jashtë kompetencave të KLSH, kjo pavarësisht kundërshtisë ligjore të dhënë dhe zyrtarisht nga KLSH me shkresën nr.2016/3, datë 17.05.2019 “ Mbi mos pengimin e procesit të auditimit të KLSH-së në AKU”. **Kriteri:** Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt, në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë, SKK 5 dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60.

Kriteri: Ligji i organik i KLSH nr.154/2014

Ndikimi: Pajisjet nuk janë të paraqitura në regjistrin e aseteve dhe për rrjedhojë s’janë të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2018.

Shkaku: Shkresa e AKU me nr. 228/3, datë 10.05.2019 që ndërpret auditimin e KLSH për mungesë kompetencash.

Rëndësia: i lartë

3.1. Rekomandim: *Nga struktura e Auditit të Brendshëm në AKU të kryhet auditim i procesit, të marrjes në dorëzim të pajisjeve të lotit 1,3,4, konform parashikimeve dhe procedurave ligjore. Auditimi i përputhshmërisë me specifikimet teknike të tyre të parashikuara në procedurat e tenderit, regjistrimet kontabël, si dhe vënia në funksionim (në përdorim) e tyre pas marrjes në dorëzimin paraprak. Për rezultatet e këtij auditimi të njoftohet KLSH.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Efektiviteti i përfitimeve konkrete, krahasuar me objektivat kryesorë të përcaktuara në kuadër të implementimit të IPA 2013 për përfituesin AKU.

Objektivi i përgjithshëm i projektit bazuar në përcaktimet e termave të referencës së projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” që do të jetë pjesë e kësaj kontrate, është të mbështesë kapacitetet administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

Dhe ku qëllimi i projektit do të jetë:

- 1. Ngritja e një rrjeti laboratorik me kosto efektive që është në gjendje të ofrojë informacion të besueshëm dhe në kohë për sigurinë e ushqimit të shitur dhe shëndetit të kafshëve, dhe*
- 2. Rritja e kapacitetit të rrjetit laboratorik për kryerjen e monitorimit dhe analizës së ushqimeve dhe prodhimit të ushqimit me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnostikimin mikrobiologjik në ushqim dhe produktet ushqim, standardet e cilësisë së ushqimit, sëmundjet e kafshëve, në përputhje me përmirësimin e standardeve.*

Rezultatet:

Rezultati 1: Një rrjet laboratorik i riorganizuar në përputhje me një kuadër të qartë ligjor dhe institucional është funksional dhe me kosto efikas,

Rezultati 2: Kapaciteti analitik dhe diagnostikues i sistemit të laboratorit rritet për shkak të trajnimit të stafit në zbatimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore.

Nga grupi i auditimit, referuar gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe konkluzioneve të rezultuara prej tij u hartua pyetësor për AKU në lidhje me këndvështrimin e këtij institucioni me rezultatet e pritshme e aktuale nga ky financim referuar objektivit kryesor dhe qëllimeve finale të projektuara për tu realizuar prej tij, krahasuar me rezultatet e arritura

Përmbajtja e pyetjeve dhe përgjigjeve më kryesore paraqitet sa më poshtë vijon:

- 1. Meqenëse projekti IPA 2013 është në vitin e fundit të përfundimit të tij, ju lutemi na paraqisni komentet dhe opinionin tuaj në lidhje me realizimin e aktiviteteve dhe përfshirjen e mendimeve tuaja gjatë realizimit të aktivitetit për arritjen e rezultateve të pritshme.*
- 2. Gjithashtu për secilin aktivitet sa më sipër, që ka lidhje me Institucionin tuaj a janë realizuar outputet e pritura gjatë implementimit të projektit deri në këtë periudhë?*
- 3. Me aktivitetet dhe produktet e përfituara prej tyre, sa janë realizuar objektivat dhe qëllimi i projektit IPA 2013?*
- 4. Si kanë ndryshuar funksionet e rrjetit Laboratorik të AKU referuar përfitimeve, në drejtim të kryerjes së detyrimeve konform ligjit?*

Përgjigje të AKU

“AKU ka në aktivitet 7 Sektorë të Shërbimeve Laboratorike të AKU, pjesë të Drejtorive Rajonale.

Programi IPA 2013 është mirëpritur nga AKU si përfitues me qëllim përforcimin e kapaciteteve të laboratorëve të tij.

Materialet e paraqitura që nga Tetor 2017 nga projekti evidentonin mangësitë dhe nevojat pas një vlerësimi të një shtate aktuale në të cilën gjendeshin lab e AKU, për të cilën AKU ishte plotësisht dakord, kjo e shprehur edhe gjatë veprimtarisë së Sektorit të Koordinimit të Laboratorëve në AKU. Pas paraqitjes së kësaj gjendje u prezantua materiali me disa propozime dhe variante për të konkluduar në strategjinë e organizimit të rrjetit laboratorik, dokument mjaft i rëndësishëm që do të rezultonte në rristurimin e rrjetit, përcaktimin e përgjegjësive, funksioneve, me buxhete të detajuara, pajisje laboratorike, alokimin e stafit, trajnimitin e tyre, për të arritur qëllimin final të akreditimit të laboratorëve të AKU për të arritur kështu qëllimin e projektit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

AKU ka komentuar, ka ngritur pyetje, ka dhënë sugjerime dhe propozime konkrete për mënyrën sesi duhet të jetë strategjia për rrjetin laboratorik të AKU. Komentet janë dhënë nga AKU për çdo letër pune të dorëzuar nëpërmjet ministrisë, dhe deri më sot nuk ka një vendim mbi strategjinë se si do të jetë riorganizimi dhe strukturimi i lab të AKU, nuk ka një përgjigje mbi statusin që kanë dokumentet e punës (working papers) dhe rrjedhimisht komentet dhe/apo propozimet e AKU nuk janë marrë parasysh.

Dokumentet e punës duhej të diskutoheshin dhe të merrej një vendim mbi to në Grupin Teknik të Punës të miratuar me Urdhër Ministri të BZHR, por AKU nuk ka dijeni që ky grup të jetë mbledhur, përveç dy rasteve.

Kjo situatë vlen edhe për pajisjen e laboratorëve, pasi AKU ka kërkuar që te pajisen apo te shpërndahen pajisje ne te 7 laboratorët, por janëpërzgjedhur 3, gjë që ne AKU ka ardhur e paracaktuar nga MBZHR.

AKU nuk ka qene pjese e përcaktimit te specifikimeve teknike te pajisjeve, as pjese e tenderimit, madje ka marre dijeni vetëm ne momentin e shpërndarjes nga MBZHR ne 3 laboratorët rajonale.

AKU ka kërkuar ne disa raste komunikim te drejtpërdrejte me Projektin, gjë e cila nuk ju lejua dhe ky komunikim u realizua vetëm ne momentin e realizimit te trajnimeve nga Projekti për stafin laboratorik te AKU. Edhe modulet e trajnimeve kane ardhur te gatshme ne AKU, përveç dy rasteve kur ështëkërkuar trajtimi i tematikave te rëndësishmepër AKU nga ana e Sektorit te Koordinimit te Lab ne DP AKU”

Theksojmë se AKU i është përgjigjur dhe një pyetësori vlerësues të kërkuar nga vlerësues të projektit “Pyetje vlerësuese për palët kryesore të programit IPA 2013 për të mbështetur "Ristrukturimin dhe Fuqizimin e Rrjetit të Labororit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Shqipëri" dhe "Përmirësimin e Mbrojtjes së Konsumatorit Kundër Sëmundjeve Zoonotike në Shqipëri"

Në këtë vlerësim nga AKU është plotësuar një tabelë e rezultateve të deritanishme të përfitimeve nga projekti si më poshtë paraqitur.

Statement	Pajtohem plotesisht	Pajtohem pjesërisht	No opinion	Nuk pajtohem	Fully disagree
1. Objektivat e Veprimeve të Projektit kanë qenë në përputhje me kërkesat e përfituesve				X	
2. Objektivat e Veprimeve kanë qenë në përputhje me nevojat e vendit				X	
3. Veprimet (aktivitetet) e dorëzuara kanë rezultuar në rritjen e kapacitetit administrativ për të monitoruar dhe kontrolluar standardet e shëndetit të kafshëve dhe të sigurisë së ushqimit në përputhje me kërkesat e BE-së		X			
4. Aktivitete e dorëzuara ishin të renditura me prioritet për të përmbushur kërkesat e BE		X			
5. Mbështetja e programit ka forcuar ndjeshëm kapacitetin e institucioneve të Sigurisë Ushqimore për të kryer detyra të caktuara.		X			
6. Mbështetja e programit ka forcuar ndjeshëm kapacitetin e institucioneve të Shëndetit të Kafshëve për të kryer detyra të caktuara.		X			
7. Si rezultat i institucioneve në fushën e mbështetjes programore tani sa janë në gjendje të monitorojnë standardet e Sigurisë Ushqimore dhe / ose të Shëndetit të Kafshëve në përputhje me kërkesat e BE-së		X			
8. Si rezultat i mbështetjes së programit, institucionet në terren tani janë në gjendje të kontrollojnë standardet e Sigurisë Ushqimore dhe / ose të Shëndetit të Kafshëve në përputhje me kërkesat e BE-së		X			
9. Programi ka përmirësuar sistemet e shëndetit të kafshëve dhe të sigurisë ushqimore duke krijuar mundësi [të dizajnuara për të ndihmuar në vend që ta pengojnë] politikën, strategjinë dhe kornizat legjislativë		X			
10. Institucionet në terren tani, si pasojë e mbështetjes së projektit, janë në gjendje të përmbushin kërkesat e BE për sigurinë e ushqimit dhe / ose shëndetin e kafshëve.		X			

Burimi AKU



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Gjithashtu në këtë material AKU i është përgjigjur dhe disa pyetjeve nga të cilat grupi i auditimit ka veçuar:

- A ka ndonjë ngjarje apo veprim që e mbylli projektin nga arritja e gjithçka që ishte planifikuar?

“Mungesa e miratimit të strategjisë. Miratimi i sajë përshpejton rezultatet e pritura. Projekti duhet të kishte ndërmarrë veprime në këtë pikë për të ndërhyrë nëpërmjet Delegacionit të BE-së apo edhe Komisionit European, duke marrë parasysh faktin se projekti kishte një TOR dhe një kontratë të nënshkruar”.

- A mund të ketë më shumë kosto efektive të mbështetjes së projektit nëse aplikohet në mënyrë të ndryshme?

“Pajisjet e laboratorëve duhet të ishin bërë krejtësisht ndryshe. Kuptimi, lista fillestare e paraqitur nga projekti u hartua për shkak të një vlerësimi të kryer në laboratorët rajonal të AKU dhe u evidentuan nevojat që ata kanë.

Ndërkohë, lista ndryshoi dhe kjo ndryshoi edhe tenderimin dhe shpërndarjen e pajisjeve (për shkak se ishin përfshirë vetëm tre prej tyre) dhe një e tërë Lot 2 mungonte. Ky Lot ishte i rëndësishëm për AKU sepse ishin të përbërë nga pajisjet e nevojshme për të trajtuar çështjet e çështjeve mikrobiologjike”.

-Cilat aktivitete duhet të përfshihen në çdo program mbështetës për të ngritur praktikën e Sigurisë Ushqimore dhe / ose Shëndetit të Kafshëve në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare?

“Laboratorët duhet të mbështeten me financime shtesë për të mbuluar boshllëqet që ka mbetur ky projekt i tanishëm.

Gjithashtu, një çështje e nxehtë për të garantuar sigurinë e ushqimit dhe për të ndërtuar besimin e konsumatorëve në autoritetin, është akreditimi i laboratorëve të AKU-së. Kjo rezulton në nevojën për alokime financiare dhe që nuk parashikohet në buxhetin e shtetit”.

Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur sa më sipër konkludojmë se objektivi, qëllimet dhe rezultatet e projektin IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” në lidhje me përfituesin AKU nuk janë përmbushur.

Aktualisht AKU nuk ka ende një Strategji të miratuar, nuk ka përfutur pajisje në atë masë që të mund të përmirësojë dukshëm nivelin e cilësisë së analizimit konform dhe funksioneve ligjore të sajë, përfshirë këtu dhe nivelin e pamjaftueshëm dhe jo themelor të bazës së temave trajnuese.

4. Përdorimi me efektivitet i pajisjeve dhe trajnimeve të përfutuara nga AKU pas periudhës së përfutimit, për kryerjen së funksioneve të saj konform kërkesave ligjore.

Aktualisht nga DRAKU Korçë, Shkodër, e Gjirokastrë referuar auditimit, u konstatua se asnjë pajisje nuk është vënë në përdorim. Këtu flitet për ato pajisje të cilat janë në kushtet e përdorimit. Argumenti i paraqitur janë tarifatat e munguara për të bërë të mundur përdorimin e tyre.

Për këtë nga AKU i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR me shkresën nr.6999, datë 5.10.2018 “Kërkesë për miratimin e tarifave të munguara në udhëzimin nr. 8, datë 8.05.2007”(ky udhëzim miratuar nga dy ministrat atë të financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit), ku në paragrafin e parë të shkresës, citohet nevoja e miratimit të tarifave për pajisjet e përfutuara. Me shkresën nr.9377/1, datë 17.10.2018 në përgjigjen e dhënë nga MBZHR konfirmohet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i dy anëtarëve nga AKU. Me shkresën nr.6999/2, datë 5.11.2018 AKU, konfirmon dy anëtarët që të jenë pjesë e grupit. Nga AKU është rikujtuar MBZHR për kërkesën e saj me i-maill-in e datës 1.2.2019 drejtuar zotit E. H. duke i vënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

bashkëlidhur dhe kërkesat e mëparëshme. Deri në këtë moment nuk ka asnjë zhvillim në lidhje me përcaktimin e tarifave.

Në VKM Nr.432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet Buxhetore”, parashikohet që tarifat për të ardhurat që realizojnë institucionet nga veprimtaria e tyre ekonomike miratohen nga Ministri i Financave me propozim të Ministrisë /institucionit qendror përkatës.

Aktualisht nga AKU dhe degët e saj nuk ka ndonjë studim për kostot e analizave për të cilat kërkohen tarifa për tu miratuar.

4. Titulli i gjetjes: *Përdorimi me efektivitet i pajisjeve dhe trajnimeve të përfituara*

Situata: Nga auditimi i kryer në DRAKU Korçë, Shkodër, u konstatua se asnjë pajisje nuk është vënë në përdorim. Këtu flitet për ato pajisje të cilat janë në kushtet e përdorimit. Argumenti i paraqitur janë tarifat e munguara për të bërë të mundur përdorimin e tyre.

Për këtë AKU i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR me shkresën nr.6999, datë 5.10.2018 “Kërkesë për miratimin e tarifave të munguara në udhëzimin nr. 8, datë 8.05.2007”(ky udhëzim është miratuar nga dy ministrat: të Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), *ku në paragrafin e parë të shkresës, citohet nevoja e miratimit të tarifave për pajisjet e përfituara. Me shkresën nr.9377/1, datë 17.10.2018 në përgjigjen e dhënë nga MBZHR konfirmohet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i dy anëtarëve nga AKU. Me shkresën nr.6999/2, datë 5.11.2018, AKU, konfirmon dy anëtarët që të jenë pjesë e grupit. Nga AKU është rikujtuar MBZHR për kërkesën e saj me i-maill-in e datës 1.2.2019 drejtuar zotit Enea Hoti duke i vënë bashkëlidhur dhe kërkesat e mëparëshme. Deri në këtë moment nuk ka asnjë zhvillim në lidhje me përcaktimin e tarifave.*

Në VKM Nr.432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet Buxhetore”, parashikohet që tarifat për të ardhurat që realizojnë institucionet nga veprimtaria e tyre ekonomike miratohen nga Ministri i Financave me propozim të Ministrisë /institucionit qendror përkatës.

Aktualisht nga AKU dhe degët e saj nuk ka ndonjë studim për kostot e analizave për të cilat kërkohen tarifa për tu miratuar.

Kriteri: Në VKM nr.432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet Buxhetore”

Ndikimi: Pajisjet nuk janë vënë në punë për mungesë tarifash.

Shkaku: Nga mos përcaktimi i këtyre tarifave dhe mos miratim nga MBZHR dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Rëndësia: i lartë

4.1 Rekomandim: *Nga ana e AKU të ngrihet grup pune për përcaktimin e kostove të realizimit të analizave që prodhohen nga përdorimi i pajisjeve të përfituara nga tre Lotet, ku në përbërjen e të cilit të jenë edhe punonjës nga të tre DRAKU- të përfituese.*

Tarifat e përcaktuara sipas kostove efektive të përdorimit të pajisjeve dhe konsumit të materialeve të nevojshme për prodhimin e analizave, ti dërgohen për vazhdimin e procedurës së miratimit të tyre në MBZHR, në referencë të procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

4.2 Titulli i gjetjes: *AKU ka pajisje të pavendosura në punë.*

Situata: Nga verifikimi në DRAKU Shkodër dhe Korçë u konstatua se disa pajisje si Banjo Mari, Centrifugë, Përzierës magetik etj, nuk janë vënë në punë. Këto pajisje nuk kanë nevojë për kalibrime, apo tarifa për tu përdorur.

Kriteri: Nga momenti i marrjes paraprake në dorëzim, në çdo DRAKU përfituese, pajisjet që janë ndihmëse dhe që nuk kanë nevojë për trajnime apo kalibrime, duhet të vihen në punë. Blerja e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

këtyre aktiveve, në kuadër të programit IPA 2013, për përmirësimin e sigurisë ushqimore në Republikën e Shqipërisë, është bërë për vënien e tyre në funksion të analizave, për të cilat janë kërkuar.

Shkaku: Mos bërje hyrje e pajisjeve në institucion.

Efekti: Mospërdorim i pajisjeve.

Rëndësia: E lartë

4.2 Rekomandime: AKU të marrë masa për vënien në punë të pajisjeve të përfituara që nuk kanë pengesa për përdorim.

Mbi trajnimet e përfituara nga AKU dhe DRAKU në kuadër të Projektit IPA 2013 si dhe efektiviteti i tyre

Vështrim i përgjithshëm i trajnimeve:

Lista e plotë e temave trajnuese që ka përfutuar AKU dhe Drejtoritë e saj, pavarësisht përfitimit apo jo të pajisjeve është sipas tabelës paraqitur më poshtë:

Nr	Tema trajnuese	Pjesëmarrja në trajnime (Po/Jo)		
		DRAKU Korçë	DRAKU Shkodër	DRAKU Gjirokastrë
1	Trajnim për inventarin laboratorik	Po	Po	Po
2	Menaxhimi i mbetjeve laboratorike	Po	Po	Po
3	Sistemi i menaxhimit laboratorik. Siguria në laborator.	Po	Po	Po
4	Testet e shpejta për falsifikimet e ushqimeve	Po	Po	Po
5	Testet e shpejta mikrobiologjike dhe mykotoksinave	Po	Po	Po
6	Trajnim teorik fiziko-kimik	Po	Po	Po
7	Trajnim teste fiziko-kimike "analiza klasike"	"Jo"	Po	Po
8	Teste "analiza specifike në produktet mish, qumësht..."	"Jo"	Po	Po
9	Teste "analiza specifike në pijet alkoolike dhe jo alkoolike dhe soft drink"	Po	Po	Po
10	Teste "aplikimi i metodave spektrofotometrike"	Po	Po	Po
11	Trajnim teorik	Po	Po	Po
12	Teste "analiza specifike në yndyrna dhe vajra"	Po	Po	Po
13	Metodat e izolimit dhe identifikimit të patogjenëve	"Jo"	"Jo"	Po
14	Teste mikrobiologjike	Po	Po	Po
15	Kërkesat për ISO 17025 standard cilësie	Po	Po	Po
16	Manual i menaxhimit të cilësisë	Po	Po	Po
17	Teknika për standardin ISO 17025	Po	Po	Po
18	Mjetet bazë në laboratorët analitik	Po	Po	Po
19	Zgjedhja e metodës analitike, Mostërmarrja ISO	Po	Po	Po
20	Analiza fiziko-kimike ushqimore, pH, titrimi, gravimetria, hiri, sipas standardeve ISO	"Jo"	Po	Po
21	Analiza fiziko-kimike, yndyrat me metodën sokslet, fibrat me gravimetri, sipas ISO	Po	Po	Po
22	Analiza fiziko-kimike për pijet alkoolike dhe joalkoolike, si edhe pijet e buta sipas ISO	Po	"Jo"	Po
23	Metodat spektrofotometrike të analizave ISO në ushqime.	Po	Po	Po
24	Analiza fiziko-kimike ISO në yndyra dhe vajra	Po	Po	Po

Burimi: AKU

Përpunuar: nga KLSH

Numri i specialistëve në trajnime ka qenë variabël sipas temave. DRAKU Korçë nuk ka marrë pjesë në 4 tema trajnuese, ndërsa DRAKU Shkodër nuk ka marrë pjesë në 2 tema trajnuese. DRAKU Gjirokastrë ka marrë pjesë në të gjitha temat trajnuese.

Siç konkludohet nga tabela, nga numri 15 deri tek numri 24 i listës së trajnimeve të kryera, nga AKU dhe DRAKU përfutuese, specialistët marrin një informacion të plotë mbi kryerjen e analizave laboratorike në përputhje me legjislacionin shqiptar. Prej vitit 2010, analizat sipas metodologjisë ISO janë të detyrueshme në Shqipëri, pas miratimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve të manualit të standardeve kombëtare, që njihen si Standarde Shtetërore ose shkurtimisht e njohur si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

SSH. Në këtë manual gjejmë të përshtatur standardet ndërkombëtare ISO në Shqipëri. Të 14 temat e mëhershme trajnuese janë teorike pa ndonjë përfitim esencial për AKU, dhe nevojat e tyre.

Pjesëmarrja dhe përfitimet për çdo DRAKU paraqitet si më poshtë vijon:

DRAKU Korçë lista e punonjësve të trajnuar	
Dh. P.	Agronom. Përgjegjës sektori i laboratorëve
Z. S.	Mjek veteriner. Specialist laboratorit mikrobiologjik.
K. L.	Mjek veteriner. Specialist i shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.
K. N.	Agronom. Specialist i laboratorit fitosanitar.
E. M.	Kimiste Ushqimore. Specialiste e laboratorit fiziko kimik.

Burimi: AKU

Përpunuar: nga KLSH

Citojmë këtu që personeli i laboratorëve të DRAKU Korçë nuk është programuar për trajnimin në 4 tema të paraqitura në tabelë pavarësisht rëndësisë së tyre sidomos për ato tema që kanë të bëjnë me pajisjet e përfituara.

Në kuadër të lotit 1 “Siguria Ushqimore” të projektit, qëllimi i të cilit ishte “*forcimi i seksioneve të testimit fiziko-kimik në DRAKU përfituese, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve*”, 6 prej 24 trajnimeve ose 25% e tyre i shërbejnë rritjes së sigurisë ushqimore, por brenda këtyre 6 trajnimeve janë dhe analizat spektrofotometrike, ku *DRAKU Korçë nuk ka përfutuar asnjë pajisje spektrofotometër.*

Në kuadër të lotit 2, “Mikrobiologjia ushqimore”, për të cilën DRAKU Korçë *nuk ka përfutuar asnjë pajisje, por ka përfutuar tre trajnime, të shfaqura me numrat 5, 13 dhe 14 në tabelën përmbledhëse të temave trajnuese paraqitur sa më sipër.*

DRAKU Korçë ka përfutuar trajnime në kuadër të qëllimit të lotit 3 “Shëndeti i Kafshëve” që ishte “*forcimi i seksioneve të testimit të shëndetit të kafshëve*” por jo të gjitha. Gjithashtu në temat e trajnimeve nuk ka trajnime që kanë lidhje me pajisjet e përfituara në këtë LOT.

DRAKU Shkodër lista e punonjësve të trajnuar	
Z. C.	Kimiste Ushqimore. Përgjegjëse e sektorit të laboratorëve
E. Z.	Biologji-kimist. Specialist i laboratorit fiziko kimik.
G. J.	Mjek veteriner. Specialist i shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.
Vakant	I paspecifikuar. Specialist i laboratorit fitosanitar.
Vakant	I paspecifikuar. Specialist laboratorit mikrobiologjik.

Burimi: AKU

Përpunuar: nga KLSH

Kjo DRAKU ka në organikën e vet 5 laborant, prej të cilëve 3 kanë marrë trajnimet sipas planifikimeve të AKU dhe Projektit IPA 2013. Një prej laboranteve është në leje mjekësore të gjatë, ndërsa një pozicion është vakant. Stafii i laboratorëve të DRAKU Shkodër ka qenë i programuar në 22 nga 24 temat e zhvilluara. Punonjësit nuk janë trajnuar në 8% të temave.

Në kuadër të Lotit 1 “Siguria Ushqimore” të projektit, qëllimi i të cilit ishte “*forcimi i seksioneve të testimit fiziko-kimik në DRAKU përfituese, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve*”, 6 prej 24 trajnimeve ose 25% e tyre i shërbejnë rritjes së sigurisë ushqimore, por brenda këtyre 6 trajnimeve janë dhe analizat spektrofotometrike, ku *DRAKU Shkodër nuk ka përfutuar asnjë pajisje spektrofotometër.*

DRAKU Shkodër nuk ka përfutuar trajnim për pajisjet e testeve të shpejta NIR Analyzer, Milk and Milk Product Analyzer, Florescent microscopic Somatic Cell Counter edhe pse ky ka qenë qëllimi i projektit për këtë lot.

Në kuadër të lotit 2, “Mikrobiologjia ushqimore”, për të cilën DRAKU Shkodër *nuk ka përfutuar asnjë pajisje, por ka përfutuar tre trajnime, të shfaqura me numrat 5, 13 dhe 14 në tabelën përmbledhëse të temave trajnuese paraqitur sa më sipër.*

DRAKU Shkodër ka përfutuar trajnime në kuadër të qëllimit të lotit 3 “Shëndeti i Kafshëve” që ishte “*forcimi i seksioneve të testimit të shëndetit të kafshëve*” por jo të gjitha. Gjithashtu në temat e trajnimeve nuk ka trajnime që kanë lidhje me pajisjet e përfituara në këtë LOT.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

DRAKU Gjirokastër lista e punonjësve të trajnuar	
Q. Z.	Mjeke Veterinere. Përgjegjës sektori i laboratorëve
E. Ç.	Kimiste teknologje. Specialist i laboratorit fiziko kimik.
S. B.	Kimi-biologji. Specialist i laboratorit fiziko kimik.
Vakant	I paspecifikuar.

Burimi AKU

Përpunuar nga KLSH

DRAKU Gjirokastër ka trajnuar 3 punonjës nga 4 që ka në strukturë pasi 1 vend është vakant. DRAKU Gjirokastër ka marrë pjesë në të gjitha temat trajnuese.

Në kuadër të Lotit 1 “Siguria Ushqimore” të projektit, qëllimi i të cilit ishte “*forcimi i seksioneve të testimit fiziko-kimik në DRAKU përfituese, përmes prokurimit të pajisjeve të nevojshme, asistencës teknike dhe parashikimit të trajnimeve*”, 6 prej 24 trajnimeve ose 25% e tyre i shërbejnë rritjes së sigurisë ushqimore, por brenda këtyre 6 trajnimeve janë dhe analizat spektrofotometrike, ku DRAKU Gjirokastër nuk ka përfituar asnjë pajisje spektrofotometër.

DRAKU Gjirokastër nuk ka përfituar trajnim për pajisjet e testeve të shpejta NIR Analyzer, Milk and Milk Product Analyzer, Florescent microscopic Somatic Cell Counter edhe pse ky ka qenë qëllimi i projektit për këtë lot.

-Në kuadër të lotit 2, “**Mikrobiologjia ushqimore**”, për të cilën DRAKU Gjirokastër nuk ka përfituar asnjë pajisje, ka përfituar tre trajnime, të shfaqura me numrat 5, 13 dhe 14 në tabelën përmbledhëse të temave trajnuese paraqitur sa më sipër.

DRAKU Gjirokastër ka përfituar për disa pajisje në kuadër të lotit 3 “**Shëndeti i Kafshëve**” ku qëllimi i të cilit ishte “*Forcimi i seksioneve të testimit të shëndetit të kafshëve në DRAKU Gjirokastër, përmes pajisjeve të përfshira në këtë lot*”. DRAKU Gjirokastër është trajnuar në metodën e izolimit dhe identifikimit të patogjenëve e cila ka përputhje me qëllimin e këtij loti, por nuk ka trajnime që kanë lidhje me pajisjet e përfituara të lotit 3.

Grupi i Auditimit i drejtoi një pyetësor AKU për përfitimin nga këto trajnime dhe standardet e arritura. Referuar përgjigjeve verbale të rezultuara nga takimi përmbyllës i realizuar në AKU, ky institucion jep këtë opinion mbi efektivitetin e trajnimeve të rezultuara sa më poshtë vijon:

1. A keni patur një program fillestar të aprovuar nga Projekti IPA 2013 për trajnimet?

AKU: “Nuk kemi pasur një program fillestar me tema të përcaktuara në lidhje me trajnimet pasi kjo do të zhvillohej në vijim të evidentimit të mangësive që do të rezultojnë nga vlerësimi i gjendjes fillestare të laboratorëve të AKU dhe strategjisë që do të miratohej më pas. Si vijim do të ndodhte pajisja dhe rrjedhimisht trajnimi i stafit laboratorik”.

2. A janë trajnimet në përputhje me objektivat specifike të projektit? Ju lutem referohuni “*Inception report*” 07.11.2016, në përgjigjet tuaja.

AKU: “Objektivat specifike të Projektit, sipas “*Inception report*”, janë:

-Ngritja e një rrjeti laboratorik kosto-eficient, në aftë për të garantuar një informacion në kohë dhe të besueshëm mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shëndetit të kafshëve.

-Nxitja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorimin dhe analizimin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve, diagnozën mikrobiologjike në ushqime dhe ushqime për kafshë, standardet e cilësisë së ushqimeve, sëmundjeve të kafshëve, në përputhje me standardet kombëtare të përmirësuar.

Në këtë kuadër, nuk rezultojnë të kemi një ngritje të rrjetit laboratorik kosto-eficiente si dhe nxitjen e kapaciteteve të rrjetit laboratorik.

Ne lidhje me përdorimin e pajisjeve specialistet nuk kanë marrë trajnim të mirëfillte pasi, nuk ishte detyrim, por janë trajnuar për pajisjet e Lot 1 për të cilat qëndronte dhe problematika e axhustimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Lot 2 nuk u tenderua dhe laboratorët nuk përfituan pajisje të këtij loti që do të mbulonin nevojat mikrobiologjike”.

3. A kanë ndikuar këto trajnime në përmirësimin e cilësisë së analizave?

AKU: *“Trajnimet kanë ndikuar në marrjen e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencave”.*

4. Si kanë ndikuar trajnimet e projektit IPA 2013 në përmirësimin e performancës së AKU në rritjen e sigurisë ushqimore, krahasuar me situatën para nisjes së implementimit të projektit?

AKU: *“Nuk ka një ndryshim krahasimor për arsye se:*

-nuk u procedua me një strategji

-nuk u investua për 7 laboratorë

-nuk u financua me pajisje për rritjen e gamës së analizave”.

5. A jeni trajnuar ju (laborantët) për përdorimin e pajisjeve të projektit?

AKU: *“Laborantet janë trajtuar për pajisjet e Lot 1”.*

6. A jeni ju të familjarizuar me kërkesat ligjore të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, për llojet e analizave të lejuara në Republikën e Shqipërisë, metodologjinë analizuuese, përpilimin e raportit të analizave për analizat që janë pjesë e veprimtarisë funksionale të AKU në përputhje me kërkesat e ligjit?

AKU: *“Laboratorët e AKU përdorin standarde të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve. Metodologjia për kryerjen e analizës është e shprehur në standarde por edhe në kërkesa ligjore (akte nënligjore) si për shembullurdhri nr. 645 datë 23.12.2016 etj.*

7. Si kanë ndikuar trajnimet në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të analizave?

AKU: *“Trajnimi ka ndikuar pozitivisht, vlen këtu të përmendim trajnimin për manualin e menaxhimit të cilësisë dhe LIMS dhe LIS”.*

8. Jepni konkluzionin tuaj nëse temat trajnuese përmbushin pritshmërinë e projektit, sipas qëllimit të çdo loti (Siguria ushqimore, Mikrobiologjia ushqimore, Shëndeti i kafshëve, Mbetjet e pesticideve).

AKU: *“Temat trajnuese plotësojnë pjesërisht pritshmërinë për projektin”.*

Sa trajtuam më sipër për trajnimet konkludojmë:

a-Temat e trajnimeve të miratuara dhe realizuara për AKU (dhe DRAKU përfituese) nga menaxhimi i projektit IPA 2013, kanë qenë përgjithësisht teorik, por pa rritur nivelin e cilësisë së analizave. Kjo situatë ka qenë e tillë deri në nisjen e auditimit. Struktura e trajnimeve ndryshon dukshëm në periudhën nga data 07.05.2019 deri në datën 15.05.2019, e cila përkon me temat e trajnimit nga nr.15 deri në nr.24 të tabelës së temave të trajnimit të paraqitura më sipër, ku përfituesit njihen konkretisht me standardet më të larta të marrjes së analizës, dhe ku pa të cilat vihet në dyshim çdo rezultat i pritshëm analizues. Njëkohësisht specialistët në këto trajnime janë njohur nga afër me standardet ISO (International Standard Organization) për analizat ushqimore.

b-Asnjë DRAKU përfituese nuk ka përfituar trajnim nga projekti për pajisjet e testeve të shpejta NIR Analyzer, Milk and Milk Product Analyzer, Florescent microscopic Somatic Cell Counter edhe pse ky ka qenë qëllimi i projektit për Lotin 1.

c-AKU nuk ka qenë përfitues i asnjë trajnimi për lotin 4 “Mbetjet e Pesticideve”, pasi rolin kryesor për këtë lot e merr ISUV. Gjithashtu, pajisjet e përfituara nga AKU në lotin 4, janë pajisje të sigurisë laboratorike, dhe nuk kanë impakt në analizimin e mbetjeve të pesticideve në produktet bujqësore.

d-Temat trajnuese kanë qenë të hapura për pjesëmarrje jo vetëm të tre DRAKU-ve përfituese, por edhe për DRAKU-të Tiranë, Durrës, Fier, Dibër dhe AKU.

f.Temat trajnuese të realizuara deri në momentin e përfundimit të këtij auditim, kanë plotësuar pjesërisht objektivat dhe qëllimin e projektit.

4.3. Titulli i gjetjes: Trajnime jo efikente.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Situata: Referuar listës së punonjësve që janë trajnuar, temave trajnuese, përputhshmërisë së temave me legjislacionin në fuqi mbi standardet e analizave në Shqipëri, risqeve të përcaktuara në raportin paraprak të projektit, që ka konstatuar se AKU përdor standarde të vjetra, të papërdorshme, u konstatua se të gjitha trajnimet deri në datën 24.04.2019, nuk përmirësojnë njohuritë e AKU dhe DRAKU-ve përfituese, për analiza sipas standardeve kombëtare.

Kriteri: Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve (DPS) ka miratuar në Prill 2010, standardet shtetërore (SSH) të cilat adoptojnë standardet ndërkombëtare ISO në Shqipëri. Çdo trajnim duhet të kryhet në përputhje me këto përcaktime të DPS.

Shkaku: AKU nuk ka komunikuar me strukturat e projektit për temat trajnuese.

Efekti: Temat trajnuese nuk kanë sjellë rritje të cilësisë së analizave.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: *AKU të marrë masa për trajnim të laborantëve me standardet në fuqi.*

4.4 Titulli i gjetjes: *Trajnime jo efiçente.*

Situata: Referuar listës së punonjësve që janë trajnuar, temave trajnuese, përputhshmërisë së temave me legjislacionin në fuqi mbi standardet e analizave në Shqipëri, risqeve të përcaktuara në raportin paraprak të projektit, që ka konstatuar se AKU përdor standarde të vjetra, të papërdorshme, u konstatua se të gjitha trajnimet deri në datën 24.04.2019, nuk përmirësojnë njohuritë e AKU dhe DRAKU-ve përfituese, për analiza sipas standardeve kombëtare.

Kriteri: Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve (DPS) ka miratuar në Prill 2010, standardet shtetërore (SSH) të cilat adoptojnë standardet ndërkombëtare ISO në Shqipëri. Çdo trajnim duhet të kryhet në përputhje me këto përcaktime të DPS.

Shkaku: AKU nuk ka komunikuar me strukturat e projektit për temat trajnuese.

Efekti: Temat trajnuese nuk kanë sjellë rritje të cilësisë së analizave.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: *AKU të marrë masa për trajnim të punonjësve të laboratorëve në të gjitha temat e planifikuara.*

4.5 Titulli i gjetjes: *Punonjësit e laboratorëve të patrajnuar për të përdorur pajisjet e reja.*

Situata: Laborantët që do të përdornin pajisjet analizuese të tipit Analyser, nuk janë trajnuar referuar aktit të marrjes provizore në dorëzim dhe listës së trajnimeve të paraqitura nga AKU.

Kriteri: Pajisjet e reja të tipit Analyser (4 të tilla për çdo DRAKU përfituese), janë pajisje të reja, që nuk disponoheshin më herët nga AKU. Laborantët referuar me “Letrën e punës numër 9, datë 14.04.2017”, duhet të trajnoheshin për përdorimin e këtyre pajisjeve, përfshirë mënyrën sesi këto pajisje kalibrohen në vijueshmëri, verifikimin e saktësisë së matjeve etj.

Shkaku: AKU nuk ka kërkuar trajnime për këto pajisje.

Efekti: Punonjësit nuk janë të familjarizuar me përdorimin e pajisjeve Analyser, gabimet që ato shfaqin, pasaktësitë, rikalibrimet.

Rëndësia: E lartë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *Drejtori i AKU, dhe Përgjegjësjja e Sektorit të Laboratorëve në AKU.*

Rekomandime: *AKU të informojë CFCU për të planifikuar trajnime që kanë të bëjnë me pajisjet e përfituara, përfshirë metodologjinë kalibruese, verifikuese për pajisjet e testeve të shpejta, në vijueshmëri të përdorimit të tyre.*

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, CFCU, SPO dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Marrja në dorëzim e përfitimeve konform kuadrit rregullator në fuqi, regjistrimet kontabël në përputhje me SKK dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare në vitet koherente të përfitimit.

B. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i kryer në Agjencinë Kombëtare të Ushqimit si përfituese e benefiteve të Projektit, në kuadër të implementimit të Projektit të financuar nga Programi IPA 2013: “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, referuar pajisjeve të përfituara nga tre Drejtori Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit rezultoi

1. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi në DRAKU Korçë mbi marrjen në dorëzim të pajisjeve të analizuesve ushqimorë kanë rezultuar 3 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:*

1-Pajisja MPA_2 (*Near Infra Red Food multiparametric analyzer*) shërben për matjen e parametrave në produktet ushqimore në; mish, grurë, fara vajore, miell, ushqime të paketuara, niseshte, sheqer, produkte brumi etj. Kjo pajisje duhet të masë disa parametra njëherazi si; lagështirë, proteinë, yndyra, hiri, amidonin, sheqerna, aciditeti, kripshmërinë, në një gjatësi valore 900-2400 nm. Aktualisht pajisja e paraqitur mat 1-3 parametra të disa produkteve dhe jo të gjitha, aq më tepër ato që konsiderohen analiza të domosdoshme për produktin që analizohet. *Pra kjo pajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Pajisja është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme dhe një pjesë analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”*

2-Pajisja MPA_3 (*Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser*) shërben për matjen e produkteve; (1) fara vajore, (2) miell, (3) grurë, (4) drithëra në një spektër drite 570-1100 nm, për parametrat kryesor; (1) proteinat, (2) lagështirën, (3) vajin, (4) fortësinë e kokrrave të drithërave, (5) përthithjen e ujit, (6) pesha hektolitrale. Aktualisht pajisja e paraqitur mat 3 produkteve për vetëm 4 parametra dhe jo për të gjithë parametrat e kërkuar.

Pra kjo pajisje nga verifikimi nuk kryen të gjitha analizat e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

Pajisja gjithashtu është e pa kalibruar (nga testimi nxjerr rezultate analizash jo të sakta) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar rezultate analizash të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”

3-Pajisja MPA_5 (*Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser*) shërben për matjen e parametrave të verës dhe produkteve të tjera alkoolike, në një fluks rrezesh infra të kuqe me frekuencë 1400-2400 nm. *Kjo pajisje është e pa kalibruar (nga testimi i produkteve ajo nxjerr një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të analizave të tyre me vlera të palogjikshme) dhe për rrjedhojë nuk është në kushte pune, për të prodhuar analiza të sakta. Sipas specifikimeve teknike kontraktori ka pranuar kushtin që pajisja “must have standard available calibrations for all the measuring parameters included with the instrument (Duhet të ketë kalibrimet të disponueshme sipas standardeve për matjen e parametrave të përfshirë në instrument).”*

Nga auditimi në DRAKU Shkodër kanë rezultuar 4 pajisjejo në përputhje me specifikimet e kërkuara për lotin 1:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

-Tre pajisjet; Near Infra Red Food multiparametric analyzer; Near Infra Red Grain Multiparametric Analyser; dhe Near Infra Red Wine and Spirits multiparametric analyser, janë të pakalibruara, dhe jo me të gjitha parametrat e kërkuara në specifikimet teknike, për rrjedhojë janë të pa përdorshme për të dhënë një rezultat të saktë laboratorik. Pajisjet duhet të kalibrohen nga furnitori sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 25/2, dhe Kushteve Specifike të kontratës të publikuara në faqen e BE për këtë projekt, në nenin 25, pika 2, paragrafi i tretë.

Gjithashtu pajisja analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët, shërben për matjen e; (1)proteinave, (2) yndyrave, (3) densitetin, (4) laktozën, (5) kripshmërinë, (6) SNF (të ngurta jo yndyrore), (7) ujë i shtuar.

Kontraktori në ofertën e vet ka ofruar që pajisja kryen edhe matjen e (8) pH, dhe (9) përcjellshmërinë elektike. Pajisja aktualisht nuk i kryen të gjitha analizat e specifikuar. Në printimin e spektrit të analizave, që kjo pajisje nxjerr, nuk shfaqet si vlerë pH dhe përcjellshmëria elektrike. Në të nuk kishte të montuar pH-metrin, shtesë që duhet të vinte bashkë me pajisjen referuar manualit të ofruar nga ofertuesi fitues.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion e njëjta situatë si dhe në DRAKU Shkodër paraqitet dhe në DRAKU Gjirokastrë.

Gjithashtu sa mësipër parashtruam për pajisjet citojmë se Kontrata “Furnizim për laboratorët ushqimorë në Drejtorinë rajonale ISFV dhe NFA” me 3 lote në total 1,937,593 Euro, nga të cilat IPA në vlerë 1,608,202 Euro dhe Buxheti i Shtetit në vlerë 329,390 Euro, me kontraktorë *Evita Ltd* për Lot 1 me vlerë 457,973 Euro pa TVSH, nga të cilat IPA 380,117 Euro dhe Buxheti i Shtetit 77,855 Euro, **është lidhur nga CFCU dhe pagesat janë kryer prej saj duke dhënë miratimin për kryerjen e pagesës, dhe duke u mjaftuar me dorëzimin e pajisjeve dhe specifikimeve teknike të kontratës, në një kohë kur nuk arriheshin rezultate të prrëshme nga pajisjet e instaluar, dhe për rrjedhojë nuk mund të siguroheshe funksionaliteti i pajisjeve për dhënien e analizave të sakta.**

Nga auditimi gjithashtu ka rezultuar se marrja provizore nga grupet e marrjes në dorëzim pavarësisht kushteve të pajisjeve, të cilat ishin (të pa axhustuara apo kolauduara) jo të gatshme për dhënien e rezultateve të sakta të analizimit për ato funksione që ato kryenin, është nxitur nga SPO dhe mbështetur dhe nga ekspertët të cilët kanë pranuar faktin e konstatuar për tre pajisjet, por me kushtin e axhustimit të tyre, i cili do të ndodhte në vijim dhe do të realizohej nga ISUV, AKU mbështetur dhe ne ndihmën e kontraktorit

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 15-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga AKU në bashkëpunim me DRAKU Korçë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2 MPA_3 MPA_5), deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës ku Inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga AKU në bashkëpunim me DRAKU Shkodër e DRAKU Gjirokastrë të mos hartohet akti i marrjes përfundimtare në dorëzim për tre pajisjet Near (MPA_2 MPA_3 MPA_5), deri në momentin e plotësimit nga furnitori të kushtit të pajisjeve të axhustuara dhe kalibruara konform kushteve specifike të kontratës, ku inspektimet dhe testimet para pranimit provizor do të bëhen në vendin ku pajisja është dorëzuar, instaluar dhe futur në punë.

-Nga AKU në bashkëpunim me DRAKU Shkodër e DRAKU Gjirokastrë ti kërkohet furnitorit pajisja e pH-metrin shtesë për pajisjen analizuese multiparametrike për qumështin dhe gjithë nënproduktet e tij në gjendje të lëngët, konform ofertës së paraqitur, si kusht për marrjen përfundimtare në dorëzim të saj.

Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

1.3.Rekomandimi:*Nga SPO në MBZHR referuar faktit të angazhimit të saj në procesin e marrjes provizore në dorëzim, në bashkëpunim me furnitorin, të hartohet menjëherë një plan i detajuar me afate kohore e përgjegjësi, për kalibrimin apo axhustimin e tre pajisjeve për të gjithë laboratorët përfitues, pa kosto shtesë nga përfituesit. Koha e përfundimit të jetë mundësisht brenda periudhës së garancisë së kontratës.*

Menjëherë

1.4.Rekomandimi:*Nga CFCU të bëhet bllokimi i garancisë së kontratës prej 10% të parashikuar në pikën 12 të njoftimit të kontratës së furnizimit për kontraktin E. Ltd për Lot 1 deri në momentin e përfundimit të procesit të axhustimit apo kolaudit të pajisjeve (sipas planit të axhustimit të miratuar nga palët). Nga CFCU në marrëdhëniet me kontraktin të zbatohen të gjitha sanksionet e parashikuara në kontratë,(dhe në rastet e mos përcaktimit në kontratë, sanksionet të vendosen në zbatim të akteve ligjore Shqiptare apo të huaja mbi të cilat funksionon kontrata) për tejkalim të afateve të dorëzimit të pajisjeve të gatshme për përdorim.*

1.5.Rekomandimi:*Nga CFCUnë rastin e dështimit të procesit të kolaudit të pajisjeve nga furnitori të nis procedurat ligjore për arkëtimin e shumave të vlerës së pajisjeve të pa kolauduara dhe jo të gatshme për punë si dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga mungesa e efektivitetit të pajisjeve për periudhën që duhet të ishin të gatshme për punë.*

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:*Nga auditimi në DRAKU Korçë e Shkodër rezultoi se pajisjet e furnizuara dhe të përfituara referuar Lotit 1, Lotit 3, Lotit 4 nuk janë bërë hyrje, për rrjedhojë nuk ka gjurmë regjistrimi në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të vitit 2018, pavarësisht se akti i marrjes në dorëzim provizor mban datën 15.11.2018 për Lotin 3 dhe 4 dhe në dhjetor 2018 për Lotin 1. Argumenti i dhënë nga zyrat e financës së DRAKU Korçë e DRAKU Shkodër ka qenë mungesa e faturës që shoqëronte mallin.*

Aktualisht mos regjistrimi në kohën e marrjes në dorëzim bie në kundërshtim me SKK5 (pasi pajisjet quhen të gatshme për përdorim). Gjithashtu mos regjistrimi kontabël bie në kundërshtim dhe me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, pikat 56,57,58,59,60.

Nga struktura urdhëruese e marrjes në dorëzim SPO e MBZHR nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni i duhur ashtu siç përcaktohet në kushtet specifike të publikuara nga BE për kontratat e projekteve IPA në artikulli 29 “Dorëzimi” ku theksohet specifikisht:

“Çdo ofertë duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:1. sigurim kontrate, 2. lista e paketimit, 3. faturë, 4. garanci certifikate (duke përfshirë procedurat e kërkesave), 5. certifikatën e origjinës (Certifikata e origjinës duhet të identifikojë qartë mallrat që i referohet).

Nga MBZHR dokumentacioni i marrjes në dorëzimi vënë në dispozicion të përfituesve, ka qenë vetëm specifikimet teknike të loteve të kontraktuara dhe ato të ofertuesit për to kjo e specifikuar dhe në urdhrat e titullarit për ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 15-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi:*Nga SPO në komunikim me CFCU të përgatitet dokumentacioni konform artikullit 29” dorëzimi” i kontratave të projekteve IPA dhe ky dokumentacion ti vihet në dispozicion Institucioneve përfituese.*

Menjëherë

2.2 Rekomandim:*Nga AKU në bashkëpunim me DRAKU Korçë, DRAKU Shkodër dhe DRAKU Gjirokastrë në bazë të dokumentacionit që duhet t’i vihet në dispozicion, të kryhet regjistrimi i aseteve (pajisje) dhe kontabilizimi në llogaritë përkatëse konform standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe akteve ligjore në fuqi.*

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT TIRANË
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

3. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i kryer në DRAKU Korçë, Shkodër, u konstatua se asnjë pajisje nuk është vënë në përdorim. Këtu flitet për ato pajisje të cilat janë në kushtet e përdorimit. Argumenti i paraqitur janë tarifave të munguara për të bërë të mundur përdorimin e tyre.

Për këtë AKU i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR me shkresën nr.6999, datë 5.10.2018 “Kërkesë për miratimin e tarifave të munguara në udhëzimin nr. 8, datë 8.05.2007”(ky udhëzim është miratuar nga dy ministrat: të Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), *ku në paragrafin e parë të shkresës, citohet nevoja e miratimit të tarifave për pajisjet e përfituara.* Me shkresën nr.9377/1, datë 17.10.2018 në përgjigjen e dhënë nga MBZHR konfirmohet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i dy anëtarëve nga AKU. Me shkresën nr.6999/2, datë 5.11.2018, AKU, konfirmon dy anëtarët që të jenë pjesë e grupit. Nga AKU është rikujtuar MBZHR për kërkesën e saj me i-maill-in e datës 1.2.2019 drejtuar zotit Enea Hoti duke i vënë bashkëlidhur dhe kërkesat e mëparshme. Deri në këtë moment nuk ka asnjë zhvillim në lidhje me përcaktimin e tarifave.

Në VKM Nr.432, datë 28.06.2006 “ Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet Buxhetore”, parashikohet që tarifave për të ardhurat që realizojnë institucionet nga veprimtaria e tyre ekonomike miratohen nga Ministri i Financave me propozim të Ministrisë /institucionit qendror përkatës.

Aktualisht nga AKU dhe degët e saj nuk ka ndonjë studim për kostot e analizave për të cilat kërkohen tarifa për tu miratuar.

Gjithashtu nga verifikimi në DRAKU Shkodër dhe Korçë u konstatua se disa pajisje si Banjo Mari, Centrifugë, Përzierës magnetik etj, nuk janë vënë në punë, pavarësisht se nuk kanë nevojë për kalibrime, apo tarifa për tu përdorur.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandim: Nga ana e AKU të ngrihet grup pune për përcaktimin e kostove të realizimit të analizave që prodhohen nga përdorimi i pajisjeve të përfituara nga tre Lotet, ku në përbërjen e të cilit të jenë edhe punonjës nga të tre DRAKU- të përfituara.

Tarifave të përcaktuara sipas kostove efektive të përdorimit të pajisjeve dhe konsumit të materialeve të nevojshme për prodhimin e analizave, ti dërgohen për vazhdimin e procedurës së miratimit të tyre në MBZHR, në referencë të procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Menjëherë

3.2. Rekomandim: Nga AKU në bashkëpunim me DRAKU përfituara, mbas regjistrimeve kontabël të marren masa për vënien në punë të pajisjeve të përfituara.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, punonjësit e laboratorëve nuk janë trajnuar nga Projekti IPA 2019 për pajisjet e përfituara, në lotin 1. Kjo në kundërshtim me “Letrën e punës numër 9, datë 14.04.2017”

-Gjithashtu punonjësit e Laboratorëve janë trajnuar deri në 24 Prill 2019 me tema të përgjithshme. Struktura e këtyre trajnimeve ka ndryshuar pas kësaj periudhe me kërkesë të AKU, duke implementuar standardet ISO dhe metodologjinë e tyre të analizave.

-Punonjësit e Laboratorëve të DRAKU-ve pjesëmarrëse në trajnime, nuk janë planifikuar të marrin pjesë në të gjithë temat e realizuara për trajnim, ku ka rezultuar se DRAKU Korçë nuk ka qenë pjesëmarrëse në 4 temadhe DRAKU Shkodër në 2 tema.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: AKU të informojë CFCU për të planifikuar trajnime që kanë të bëjnë me pajisjet e përfituara, përfshirë metodologjinë kalibruese, verifikuese për pajisjet e testeve të shpejta, në vijueshmëri të përdorimit të tyre. AKU të marrë masa për trajnim të laborantëve me standardet në fuqi.



Menjëherë

4.2 Rekomandim: AKU të marrë masa për trajnim të punonjësve të laboratorëve në të gjitha temat e planifikuara.

Menjëherë

Nga AKU me shkresën nr 2281/6 datë 5.07.2019 të konfirmuar nga titullari i institucionit (protokolluar në KLSH me datë 8.7.2019) janë paraqitur komente për projektraportin e KLSH.

